



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



## **Raporti Final**

**Përshtatjet Vjetore për të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU, OSSH dhe  
OST/OT për vitin tarifor 2026**

**Përgjigje ndaj Komenteve**

### **Deklaratë**

**Ky Raport Final është përgatitur nga ZRRE-ja me qëllim të informimit të palëve të interesit. Ky Raport duhet të lexohet krahas Raporteve Konsultative të ZRRE-së të publikuar më 10 prill 2026. Raporti nuk përfaqëson një vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të interpretohet si i tillë.**

**5 maj 2026**



## Përmbajtja

<b>Hyrje .....</b>	<b>4</b>
<b>1 Procesi i Përshtatjeve të rregullta dhe kompetencat e ZRRE-së .....</b>	<b>5</b>
1.1 Përmbledhje e procesit të shqyrtimeve të rregullta.....	5
1.2 Përgjegjësitë e ZRRE-së për tarifa .....	6
1.2.1 Obligimi ligjor për të reflektuar kostot në tarifa.....	6
1.2.2 Masat e ndërmarra për të rritur efikasitetin e operatorëve.....	7
1.3 Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në koston e shërbimit.....	7
1.3.1 Krahasimi i kostove të parashikuara dhe reale të blerjes së energjisë (viti paraprak) ...	7
1.3.2 Parashikimi i kostove të importit .....	9
1.3.3 Kostot Shtesë .....	10
<b>2 Të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut OST/OT</b>	<b>10</b>
<b>3 Të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes OSSH (KEDS).....</b>	<b>12</b>
<b>4 Të Hyrat e Lejuara Maksimale për Furnizuesin e Shërbimit Universal FSHU (KESCO) .....</b>	<b>13</b>
<b>ANEKSI 1 Komente nga Shoqëria Civile – Organizata INDEP .....</b>	<b>15</b>
<b>ANEKSI 2 Përgjigje ndaj komenteve të ndërmarreve energjetike .....</b>	<b>35</b>
A2.1 KOSTT (OST/MO).....	35
A2.1.1 Kostoja e blerjes së humbjeve në transmetim.....	35
A2.1.2 Kostot e shërbimeve ndihmëse .....	36
A2.1.3 Shpenzime të tjera operative.....	37
A2.1.4 Shpenzime kapitale .....	37
A2.2 KEDS (OSSH) .....	40
A2.2.1 Kostot e lidhura me hapjen e tregut.....	40
A2.2.2 Kostot operative dhe të mirëmbajtjes .....	40
A2.2.3 Shpenzimet operative në komunat veriore .....	41
A2.2.4 Kostot investive.....	42
A2.2.5 Vëllimet e humbjeve .....	42
A2.2.6 Çmimi i blerjes së energjisë.....	43
A2.2.7 Të ardhurat e parregulluara.....	45



A2.3	KESCO (FSHU).....	46
A2.3.1	Çmimet e parashikuara të shitjes me shumicë .....	46
A2.3.2	Ndikimi i ndërprerjeve në Kosova A dhe Kosova B dhe profilizimi i kostove.....	47
A2.3.3	Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes .....	48
A2.3.4	Kostot e bartshme (pass-through costs).....	49
A2.4	KEK.....	51
A2.4.1	Ndryshimet në tarifat e OST/OT dhe OSSH të paguara nga KESCO .....	51
A2.4.2	Kostot e humbjeve të përfshira në të ardhurat e lejuara të OST dhe OSSH .....	51
A2.4.3	Zvoglimi e tarifës së operimit të sistemit.....	52
A2.5	Elektroserver .....	53
A2.5.1	Tarifa për shërbimet e shpërndarjes në komunat veriore.....	53
A2.5.2	Niveli i investimeve në komunat veriore .....	53
A2.5.3	Niveli i lejuar i humbjeve.....	54



## Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aktualisht po kryen procesin e përshtatjeve të rregullta të të hyrave që duhet të rikuperohen nga entitetet e rregulluara në sektorin e energjisë elektrike. Si pjesë e këtij procesi, ZRRE përshtat dallimet ndërmjet vlerave të parashikuara dhe atyre reale të përcaktuesve të Hyrave të Lejuara Maksimale (HLM), të cilat mund të paraqiten si rezultat i faktorëve jashtë kontrollit të kompanive të rregulluara.

Më 10 prill 2026, ZRRE publikoi Raportin Konsultativ për përcaktimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Transmetimit, dhe Tregut (OSTOT-KOSTT), Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH-KEDS) dhe Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU – KESCO). Këto raporte konsultimi u publikuan për të mbledhur komente nga palët e interesit lidhur me vlerësimet dhe rregullimet e propozuara nga ZRRE.

Ftesa e ZRRE-s për komente ka nxitur interes të konsiderueshëm, me përgjigje të pranuar nga një organizatë e shoqërisë civile – INDEP, dhe pesë të licencuar: KOSTT, KEDS, KESCO, KEK dhe Elektroserver.

Ky dokument paraqet një përmbledhje të konsoliduar të komenteve të pranuar, së bashku me përgjigjet e ZRRE-s. Ai është i strukturuar si më poshtë:

- Kapitulli 1 ofron një pasqyrë të procesit të rregullimit të rregullt, përfshirë faktorët kryesorë të kostos së shërbimit dhe kompetencat rregullatore të ZRRE-s;
- Kapitulli 2 paraqet të Hyrat e Lejuara Maksimale dhe Raportin Përfundimtar për Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST/OT);
- Kapitulli 3 paraqet të të Hyrat e Lejuara Maksimale dhe Raportin Përfundimtar për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH); dhe
- Kapitulli 4 paraqet të të Hyrat e Lejuara Maksimale dhe Raportin Përfundimtar për Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU).

Një përmbledhje e detajuar e përgjigjeve të ZRRE-së ndaj komenteve të palëve të interesit është paraqitur në Aneksin e këtij dokumenti.



## Dokumentet Relevante

Rregulla për të të Hyrat e Lejuara Maksimale për OST/OT	<a href="#">Link</a>
Rregulla për të të Hyrat e Lejuara Maksimale për OSSH	<a href="#">Link</a>
Rregulla për të të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU	<a href="#">Link</a>
Raporti Konsultativ për të të Hyrat e Lejuara Maksimale të OST/OT-së	<a href="#">Link</a>
Raporti Konsultativ për të të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH-së	<a href="#">Link</a>
Raporti Konsultativ për të të Hyrat e Lejuara Maksimale të FSHU-së	<a href="#">Link</a>

## 1 Procesi i Përshtatjeve të rregullta dhe kompetencat e ZRRE-së

Ky kapitull paraqet një përmbledhje të procesit të përshtatjes së rregullt të hyrave dhe shpjegon se si këto rregullime sigurojnë që kostot e sistemit të reflektohen në mënyrë të duhur në të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) dhe, rrjedhimisht, në tarifat për konsumatorët fundorë. Llogaritjet e detajuara të të Hyrat e Lejuara Maksimale paraqiten në kapitujt përkatës të Raporteve të Konsultimit për HLM për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT), Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) dhe Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU).

Ky kapitull është i strukturuar si më poshtë:

- Kapitulli 1.1 ofron një pasqyrë të procesit të përshtatjeve të rregullta dhe përshkruan dallimet kryesore ndërmjet përshtatjeve të rregullta dhe shqyrtimit periodik (tarifor);
- Kapitulli 1.2 përmbledh faktorët kryesorë që kanë kontribuar në ndryshimet e kostos së shërbimit, me theks të veçantë në rritjen e kostove; dhe
- Kapitulli 1.3 shpjegon mandatin ligjor të ZRRE-së, si dhe masat e ndërmarra për të rritur efikasitetin operacional të entiteteve të rregulluara.

### 1.1 Përmbledhje e procesit të shqyrtimeve të rregullta

Të Hyrat dhe tarifat e energjisë në Kosovë përcaktohen përmes dy proceseve të dallueshme rregullatore: shqyrtimit periodik dhe përshtatjeve të rregullta. Këto procese shërbejnë për qëllime të ndryshme dhe zhvillohen sipas afateve të ndryshme kohore:

- *Shqyrtimi periodik* – realizohen çdo pesë vjet dhe përcaktojnë komponentët kryesorë të të Hyrave të Lejuara Maksimale (HLM) që janë relativisht të qëndrueshëm gjatë periudhës rregullatore. Këtu përfshihen elemente si planet e investimeve, kostot operative dhe të mirëmbajtjes (O&M), si dhe parametra të tjerë që nuk pritet të ndryshojnë ndjeshëm nga viti në vit.



- *Përshtatje e rregullt* – realizohen çdo vit dhe shërbejnë për të barazuar dallimet ndërmjet vlerave të parashikuara (të lejuara) dhe atyre reale të komponentëve të kostos që mund të ndryshojnë nga viti në vit. Këta komponentë përfshijnë, për shembull, kostot e blerjes së energjisë me shumicë, vëllimet reale të energjisë, inflacionin dhe kosto të tjera që konsiderohen jashtë kontrollit të entiteteve të rregulluara.

Rishikimi aktual i të hyrave dhe tarifave të energjisë elektrike po zhvillohet në kuadër të procesit të Përshtatjeve të Rregullta. Krahasuar me shqyrtimet periodike, ky proces është më pak kompleks, pasi përfshin një nivel më të kufizuar diskrecioni rregullator dhe fokusohet kryesisht në përditësimin e elementeve specifike të kostos, në vend të ripërcaktimit të të gjithë kornizës rregullatore. Si rezultat, përshtatjet e rregullta realizohen brenda një afati më të shkurtër rishikimi.

## **1.2 Përgjegjësitë e ZRRE-së për tarifa**

Ky kapitull sqaron kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe përgjegjësinë e saj për reflektimin e kostos së shërbimit në tarifat e energjisë elektrike. Kapitulli është i organizuar si më poshtë:

- Kapitulli 1.2.1 paraqet obligimet ligjore të ZRRE-s për të vendosur një çmim që pasqyron koston e shërbimit;
- Kapitulli 1.2.2 paraqet masat që ZRRE ka ndërmarrë për të siguruar që kompanitë e rregulluara të jenë gjithashtu nën presion për të ulur koston e shërbimit.

### **1.2.1 Obligimi ligjor për të reflektuar koston në tarifa**

Kompetencat e ZRRE-s për tarifat e energjisë elektrike janë të përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084 i vitit 2016).

Neni 15 i Ligjit ndalon vendosjen e tarifave nën koston e shërbimit (Neni 15.4.2):

*(15.4) Në rastet kur Rregullatori rregullon çmimin e energjisë elektrike për konsumatorët fundorë, dhe i...*

*(4.2) siguron që çmimet e energjisë elektrike që i nënshtrohen rregullimit të çmimeve për qëllim të sigurimit të shërbimit universal të pasqyrojnë koston e shërbimit.*

Për më tepër, ZRRE nuk duhet të lejojë subvencionim të kryqëzuar të tarifave ndërmjet kategorive të konsumatorëve (Neni 15.4.1):

*(4.1) siguron që kategori të ndryshme të konsumatorëve të mos përfitojnë nga trajtim dhe mbrojtje e njëjtë dhe që rregullimi i çmimeve për konsumatorët fundorë të jetë i disponueshëm vetëm për të siguruar ofrimin e shërbimit universal për konsumatorët familjarë dhe konsumatorët që gëzojnë të drejtën për shërbim universal.*



Ligji parashikon mbrojtje për konsumatorët në nevojë në formën e subvencioneve, por këtë përgjegjësi ia atribuon Qeverisë, përkatësisht Ministrisë përgjegjëse për mirëqenie sociale, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Neni 50:

*(3) Qeveria, përmes programit të saj të përgjithshëm për kategoritë sociale të shoqërisë, do të trajtojë çështjen e kategorive sociale të konsumatorëve të energjisë. Ky program do të zbatohet nga Ministria përgjegjëse për mirëqenie sociale.*

### **1.2.2 Masat e ndërmarra për të rritur efikasitetin e operatorëve**

Qëllimi i modelit të rregullimit ekonomik të aplikuar nga ZRRE është të inkurajojë kompanitë të përmirësojnë efikasitetin operacional përmes rregullimit me stimuj të bazuar në performancë. Instrumentet kryesore të ZRRE-s në këtë drejtim janë faktori i efikasitetit dhe stimujt për reduktimin e humbjeve:

1. **Faktori i efikasitetit (OSSH dhe OST/OT)** – përfaqëson përmirësimin e pritshëm të kompanive të rregulluara në kostot operative dhe të mirëmbajtjes, i përcaktuar në 1.5% për çdo vit të periudhës rregullatore (reduktim prej 1.5% në kostot operative dhe të mirëmbajtjes për çdo vit gjatë periudhës 2023–2027);
2. **Objektivi për reduktimin e humbjeve (OSSH)** – përfaqëson trendin e uljes së humbjeve të lejuara mbi të cilat nuk mund të aplikohet tarifa e rregulluar (ulje e nivelit të humbjeve të lejuara nga 15.1% në 11.1% gjatë periudhës 2023–2027).

### **1.3 Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në koston e shërbimit**

Ky kapitull i Raportit të Konsultimit synon të paraqesë një pasqyrë të përmbledhur të faktorëve kryesorë që kanë kontribuar në rritjen e koston të shërbimit të energjisë elektrike. Ai nuk synon të përsërisë analizat e detajuara të paraqitura në pjesë të tjera të raportit, por të theksojë nxitësit më të rëndësishëm të koston.

Kapitulli është i strukturuar si më poshtë:

- Kapitulli 1.3.1 paraqet dallimet ndërmjet kostove të lejuara dhe atyre reale të prokurimit të energjisë në vitin paraprak;
- Kapitulli 1.3.2 përshkruan parashikimin e ZRRE-s për kostot e lejuara të importeve për vitin 2026; dhe
- Kapitulli 1.3.3 paraqet kostot shtesë të lidhura me balancimin e sistemit të energjisë elektrike.

#### **1.3.1 Krahasimi i kostove të parashikuara dhe reale të blerjes së energjisë (viti paraprak)**

Energjia e furnizuar për të përmbushur kërkesën e konsumatorëve të rregulluar të energjisë elektrike përbëhet nga prodhimi vendor, i ofruar kryesisht nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) dhe Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), si dhe nga energjia e importuar.




Para çdo viti tarifor, ZRRE përgatit një parashikim të kostove të prokurimit të energjisë me shumicë, duke marrë parasysh vëllimet e pritshme të energjisë të furnizuara nga KEK, BRE dhe importet. Ky vlerësim përfshin gjithashtu projeksionet e çmimeve të energjisë nga secili burim. Bazuar në këto supozime, çmimi mesatar i ponderuar i parashikuar për importet për vitin 2025 ishte 161.28 EUR/MWh.

Në fund të çdo viti tarifor, ZRRE kryen një barazim ndërmjet kostove reale dhe atyre të parashikuara të prokurimit të energjisë. Kjo përfshin rregullime për devijimet si në vëllimet e energjisë ashtu edhe në çmimet e blerjes për të gjitha burimet e furnizimit. ZRRE siguron që të njihen vetëm kostot e bëra nga të licencuarit që janë të arsyeshme dhe të justifikuar.

Sa i përket çmimeve, energjia elektrike e prodhuar nga KEK dhe BRE furnizohet në bazë të marrëveshjeve afatgjata kontraktuale, me çmime që mbeten të qëndrueshme gjatë gjithë vitit. Në të kundërt, kostot e importeve janë subjekt i luhatjeve të tregut. Për Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU), çmimi mesatar i ponderuar i realizuar i energjisë së importuar, duke përfshirë kostot e kapaciteteve të transmetimit, arriti në 146.21 EUR/MWh.

Çmimi mesatar i ponderuar i realizuar i importeve (146.21 EUR/MWh) ishte rreth 10% më i ulët se niveli i parashikuar (161.28 EUR/MWh). Megjithatë, për shkak të një rritjeje të konsiderueshme të vëllimeve të importeve për shkaqe të prodhimit të pamjaftueshëm vendor, nga 243.75 GWh të parashikuara në 514.54 GWh të realizuara, kostoja totale e importeve të energjisë për vitin 2025 arriti në 75.23 milionë €, që është 35.91 milionë € më e lartë se kostoja e planifikuar prej 39.31 milionë €. Ky devijim i koston i nënshtrohet rikuperimit përmes tarifave të ardhshme të energjisë elektrike.

**Figura 1 Dallimet ndërmjet kostos së parashikuar dhe asaj reale të blerjes së energjisë (FSHU)**



Në rastin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), kostoja e prokurimit të energjisë ndikohet më fuqishëm nga çmimet e importeve. Kjo ndodh sepse energjia e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet mund të sigurohet nga prodhimi vendor vetëm pasi të jetë përmbushur plotësisht kërkesa e konsumatorëve të shërbimit universal.

Në situata kur kërkesa për energji elektrike tejkalon nivelet e parashikuara, si në muajt janar, shkurt dhe dhjetor, OSSH detyrohet të rrisë importet, pasi kapaciteti i disponueshëm i prodhimit të KEK-ut kryesisht është i dedikuar për furnizimin e konsumatorëve të shërbimit universal.


Çmimi mesatar i ponderuar i parashikuar i importeve për vitin 2025 ishte 145.76 EUR/MWh, ndërsa çmimi mesatar i ponderuar i realizuar i importeve arriti në 141.67 EUR/MWh. Megjithatë, për shkak



të një rritjeje të konsiderueshme të vëllimeve të importeve, nga 488.04 GWh të parashikuara në 647.71 GWh të realizuara, kostoja totale e importeve të energjisë për vitin 2025 arriti në 91.76 milionë €, që është 20.62 milionë € më e lartë se kostoja e planifikuar prej 71.13 milionë €. Ky devijim i koston i nënshtrohet rikuperimit përmes tarifave të ardhshme të energjisë elektrike.

Një përmbledhje e kostove të prokurimit të energjisë të OSSH-së paraqitet në figurën më poshtë.

**Figure 2 Dallime në kostot dhe çmimet e furnizimit me energji elektrike 2025 për OSSH**




### 1.3.2 Parashikimi i kostove të importit

Ky seksion trajton barazimin ndërmjet kostove të lejuara dhe atyre reale për vitin paraprak (2025). Përveç rregullimit të kostove të vitit tarifor të kaluar, çdo rregullim i rregullt përfshin gjithashtu një parashikim të kostove të prokurimit të energjisë me shumicë për vitin tarifor në vijim.

Sa i përket çmimeve të importeve, parashikimi i ZRRE-s bazohet në trendet afatgjata të evidentuara të tregut (p.sh. HUDEX) dhe bursat rajonale të energjisë (PX), si dhe në rritjen e çmimeve të energjisë ndërkufitare gjatë vitit 2026 krahasuar me vitin 2025. Bazuar në këta faktorë, ZRRE pret që çmimet e importeve të jenë më të larta se sa ishte parashikuar fillimisht për vitin 2026, por më të ulëta se çmimet e realizuara gjatë të vitit paraprak.

**Figura 3, Parashikimi/Realizimi 2025 dhe Parashikimi 2026**



Për më tepër, rehabilitimi afatgjatë i planifikuar i njësive gjeneruese të KEK-ut gjatë vitit 2026 pritet të ndikojë në kostot e prokurimit të energjisë, pasi çdo mungesë në prodhimin vendor do të duhet të kompensohet përmes rritjes së importeve.



### 1.3.3 Kostot Shtesë

**Shërbimet ndihmëse** – Çdo sistem elektroenergetik duhet të sigurojë rezervat e nevojshme për operimin e sistemit (ruajtjen e frekuencës dhe tensionit të energjisë elektrike). Për shkak të kërkesave dhe vëzhgimeve nga ENTSO-E lidhur me devijimet në sistemin evropian të interkoneksionit, rezerva automatike aFRR është rritur nga +/- 25 MW në +/- 40 MW. OST/OT e siguron këtë rezervë përmes ankandeve javore nga Shqipëria. Çmimet për këto shërbime ndryshojnë çdo muaj dhe variojnë në varësi të llojit të kapacitetit të ofruar dhe kohëzgjatjes. Çmimet e parashikuara për shërbimet aFRR bazohen në çmimet e realizuara. Rezerva manuale mFRR për vitin 2025 është kontraktuar me ofruesin e shërbimit (KESH), me kapacitete prej +196 MW për rritje dhe -50 MW për ulje.

Detyrimi për rezervat buron nga Kodi i Rrjetit (Kodi i Balancimit), ndërsa çmimet e rezervave i nënshtrohen kriterëve të tregut mbi të cilat ZRRE nuk ka kontroll, në përputhje me Nenin 13.2 të Rregullave të Tregut. Ndikimi i kombinuar i kostove të shërbimeve ndihmëse gjatë vitit 2025 është 39.4 milionë €, krahasuar me vlerën e miratuar nga ZRRE prej 37.71 milionë €. Diferenca ndërmjet këtyre vlerave duhet të reflektohet në tarifat e energjisë elektrike për vitin 2026.

## 2 Të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut OST/OT

Ky kapitull përmbledh rishikimet e bëra nga ZRRE gjatë procesit të konsultimit publik, si dhe propozimin përfundimtar të ZRRE-s për të Hyrat e Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT), të cilat do të mbledhen përmes tarifave të rregulluara. HLM i paraqitur në këtë kapitull merr parasysh përgjigjet ndaj komenteve (shih Aneksin 2 për të gjitha përgjigjet ndaj komenteve). Gjatë procesit, ZRRE ka rishikuar kostot e parashikuara të humbjeve për vitin 2026, si dhe kostot e shërbimeve ndihmëse për OST-në.

ZRRE duke i analizuar:

- Aplikacionin e OST/OT (KOSTT) për të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin tarifor 2026
- Raportin Konsultativ të publikuar nga ZRRE
- Komentet nga palëve e në veçanti komentet e KOSTT-it, lidhur me realizimin e blerjeve të muajit mars 2026 dhe përditësimet e bëra për realizimet e shërbimeve ndihmëse për muajt janar-mars 2026

ZRRE, përmes mekanizmit të faktorit korrigjues të të hyrave (KREVT), ka reflektuar dallimet ndërmjet kostove të lejuara dhe atyre të realizuara për vitin paraprak për kostot jashtë kontrollit të të licencuarve, si humbjet, shërbimet ndihmëse dhe Fondi për BRE.

Ndërkohë, KOSTT i bart këto diferenca drejtpërdrejt në kostot e vitit 2026. Kjo nuk ndikon në nivelin total të të hyrave, por vetëm në shpërndarjen e tyre ndërmjet komponentëve tariforë.

Në këtë kuadër, kostot e Fondit për BRE janë zvogëluar për rreth 5.6 milion € të vitit paraprak 2025, duke rezultuar në një kosto prej rreth 1.2 milion € për vitin 2026, e cila është bazë për tu llogaritur tarifa e fondit nga KOSTT.



ZRRE propozon të Hyrat e Lejuara Maksimale për OST/OT për vitin 2026 si në Tabelën në vijim:

**Tabela 1** Propozimi final për të Hyrat e Lejuara Maksimale për KOSTT për vitin 2026

Propozimi për HLM për KOSTT 2026 Komponenti	Njësia	Propozimi KOSTT	Raporti Konsultativ ZRRE	Raporti Final ZRRE
		2026	2026	2026
OPEX	€ mil	9.16	8.11	8.11
Zhvlerësimi	€ mil	14.38	14.38	14.38
Kthimi i Lejuar	€ mil	11.23	11.24	11.24
Blerja e Energjisë për Humbjet	€ mil	15.76	12.112	12.068
Fondi	€ mil	18.68	6.85	6.85
Shërbimet Ndhmëse	€ mil	45.00	39.64	40.309
Të Hyrat e Parregulluara	€ mil	-8.31	-8.31	-8.31
Të Hyrat nga Mekanizmi ITC	€ mil	-0.21	-0.21	-0.21
Përshtatjet për (2022 dhe PR2)	€ mil	-5.42	-5.42	-5.421
KREvt = (AACat-1 – ARRt-1) * (1+ It)	€ mil	-0.88	-2.53	-2.53
<b>Gjithësejt të Hyrat e Lejuara Maksimale</b>	<b>€ mil</b>	<b>99.383</b>	<b>75.858</b>	<b>76.484</b>

ZRRE në Raportin Final propozon që HLM për OST/OT (KOSTT) për vitin 2026 të jenë **€76.484 mil**.

Vlera totale e të Hyrave të Lejuara maksimale (HLM) në raportin final është për **€ 0.625 mil** më e lartë se vlera e propozuar në Raportin Konsultativ. Arsyet e kesaj rritje janë dhënë në komentet në shtojcën 2, por të pëmbledhura janë si në vijim:

- *Blerja e Energjisë për Humbje* – kjo kosto është për **€ 0.043 mil**. më e ulët se propozimi në Raportin Konsultativ, për shkak të përfshirjes së kostove reale për muajin mars dhe përditësimin të parashikimeve të blerjeve për pjesën e mbetur të vitit.
- *Shërbimet Ndhmëse* – kjo kosto është për **€ 0.669 mil** më e lartë se vlera e propozuar në Raportin Konsultativ, për shkak përfshirjes së kostove reale për muajin janar – mars, 2026, kjo bazuar nga raportet mujore të paraqitura nga KOSTT, kurse për muajt prill – dhjetor, 2026 parashikimet kanë mbetur të njejta.



### 3 Të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes OSSH (KEDS)

Propozimet përfundimtare të ZRRE-së-s për HLM për OSSH-në (KEDS) paraqiten më poshtë, së bashku me propozimet e dhëna në Raportin Konsultativ dhe aplikacionin origjinal të OSSH-së (Tabela 2). Krahasuar me propozimin në Raportin Konsultativ, ZRRE në propozimet e saj përfundimtare ka rritur HLM për 1.22 milionë € (0.7%). Të HLM përfundimtare të propozuara prej 185.96 milionë €, është për 49.42 milionë € (21%) më e ulët se vlera e paraqitur në aplikacionin e OSSH-së.

ZRRE ka bërë ndryshimet e mëposhtme ndërmjet propozimeve në Raportin Konsultativ dhe atyre përfundimtare:

Ka zëvendësuar koston fillestare të parashikuar të blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve në propozimin në Raportin Konsultativ për mars 2026 me koston aktuale.

Ka rritur çmimin e supozuar të importit për muajt e mbetur të vitit 2026 për 2.65 €/MWh.

Shpjegimi i këtyre ndryshimeve dhe shqyrtimi i komenteve të tjera të pranuar mbi propozimet nga OSSH dhe palët janë të përfshira në Aneksin 2.

**Tabela 2.** Aplikimi, propozimi në raportin konsultativ dhe propozimi final për të HLM për OSSH

Propozimi për HLM për OSSH 2026 Komponenti	Njësia	Propozimi OSSH	Raporti Konsultativ ZRRE	Raporti Final ZRRE
		2026	2026	2026
Taksat për OST / OT	€ mil	9.16	8.11	8.11
OPEX	€ mil	39.391	32.752	32.752
Zhvlerësimi	€ mil	24.614	23.396	23.396
Kthimi i Lejuar	€ mil	20.083	19.424	19.424
Blerja e Energjisë për Humbjet	€ mil	107.410	80.752	81.602
Të Hyrat e Parregulluara	€ mil	-2.704	-5.408	-5.408
Përshtatjet për (2022 dhe PR2)	€ mil	0.471	0.089	0.089
KREVT = (AACat-1 – ARRT-1) * (1+ It)	€ mil	41.857	30.108	30.473
<b>Gjithësejt të Hyrat e Lejuara Maksimale</b>	<b>€ mil</b>	<b>235.384</b>	<b>184.746</b>	<b>185.961</b>



#### 4 Të Hyrat e Lejuara Maksimale për Furnizuesin e Shërbimit Universal FSHU (KESCO)

Propozimet përfundimtare të ZRRE-së për të HLM për FSHU-në (KESCO) paraqiten më poshtë, së bashku me propozimet e bëra në Raportin Konsultativ dhe aplikacionin origjinal të FSHU-së (Tabela 3). Krahasuar me propozimet në Raportin Konsultativ, ZRRE në propozimet e saj përfundimtare i ka ulur HLM me 0.15 milionë € (0.03%). Të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) përfundimtare të propozuara prej 442.23 milionë € janë për 86.55 milionë € (16%) më të ulëta se vlera e paraqitur në aplikacionin e FSHU-së.

ZRRE ka bërë ndryshimet e mëposhtme përfundimtare krahasuar me propozimet në Raportin Konsultativ:

- Ka zëvendësuar koston fillestare të parashikuar të blerjes me shumicë të energjisë për mars 2026 me koston aktuale.
- Ka rritur çmimin e supozuar të importit për muajt e mbetur të vitit 2026 me 2.65 €/MWh.

Këto ndryshime në kostot e blerjes me shumicë të energjisë gjithashtu rezultojnë në ndryshime të vogla në elemente të tjera të llogaritjes së HLM-së, të cilat janë të lidhura me kostot e blerjes së energjisë (marzhi i shitjes me pakicë, lejetimet për borxhe të këqija, kostot e kapitalit qarkullues).

Shpjegimi i këtyre ndryshimeve dhe shqyrtimi i komenteve të tjera të pranuar nga FSHU dhe palët e interesit mbi propozimet në Raportin Konsultativ janë përfshirë në Aneksin 2.

**Tabela 3.** Aplikimi, propozimi në raportin konsultativ dhe propozimi final për HLM për FSHU

Propozimi për HLM për FSHU 2026 Komponenti	Njësia	Propozimi	Raporti	Raporti
		FSHU	Konsultativ	Final
		2026	ZRRE	ZRRE
			2026	2026
Taksat për OST / OT	€ mil	32.125	32.365	31.644
Taksat e OSSH-së	€ mil	180.309	157.474	158.473
Fondi BRE	€ mil	15.507	8.079	8.724
Margjina me pakicë	€ mil	11.137	8.354	8.354
Kostoja e Blerjes së Energjisë me Shumicë	€ mil	229.044	177.801	176.310
Lejimi për Borxhin e keq	€ mil	8.500	7.322	7.292
Lejimet e kapitalit punues	€ mil	2.616	2.685	2.681
KREvt = (AACat-1 – ARRT-1) * (1+ It)	€ mil	49.541	48.298	48.902
<b>Gjithësejt të Hyra Maksimale të Lejuara</b>	<b>€ mil</b>	<b>528.779</b>	<b>442.377</b>	<b>442.229</b>

ZRRE vlerëson se, nën tarifatat aktuale, FSHU do të rikuperojë 442.23 milionë € të hyrat për vitin 2026.



Gjithashtu, siç diskutohet më në detaje në Aneksin 2, rehabilitimi i planifikuar i termocentraleve Kosova A dhe B gjatë vitit 2026 pritet të ulë prodhimin vendor gjatë këtij viti, por të përmirësojë besueshmërinë dhe prodhimin e termocentraleve në vitet në vijim. Përderisa rehabilitimi është në zhvillim do të ketë nevojë për sasi më të larta të importi, si pasojë kosto më të larta për konsumatorë, por pritet që të ketë ulje të kostove nga viti 2027 e tutje, e kjo si rezultat që Kosova A dhe B do të jenë në gjendje të operojnë më me besueshmëri dhe të zëvendësojnë importet.

ZRRE, lidhur me profilizimin e kostove të furnizimit, ka vlerësuar se aplikimi i këtij mekanizmi është i nevojshëm për të zbutur ndikimin tarifor në vitin 2026, duke ruajtur stabilitetin financiar të FSHU-së dhe sigurinë e furnizimit.

ZRRE konstaton se KEK Sh.A. dhe FSHU (KESCO Sh.A.) kanë arritur marrëveshje për riprogramimin e borxhit për faturat e periudhës janar–mars 2026 (nr. 1008904, 1009081 dhe 1009284), e cila konsiderohet mekanizëm legjitim i profilizimit. Kostot dhe obligimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje do të trajtohen si të arsyeshme në shqyrtimet e ardhshme tarifore.

Për të zbutur ndikimin në faturat e konsumatorëve në vitin 2026, KEK dhe KESCO kanë rënë dakord reciprokisht të shtyjnë një pjesë të pagesave për blerjen e energjisë që mbulojnë periudhën janar–mars 2026 (afërsisht 39 milionë € me TVSH) për në vitin 2027, kur kostot e blerjes së energjisë pritet të jenë më të ulëta. Kjo shtyrje është reflektuar në tarifat e propozuara si një ulje e kostove të blerjes së energjisë në vitin 2026, ndërsa shuma e shtyrë (përfshirë edhe kostot e tjera përcjellëse), sipas Aneks Marrëveshjes do të shtohet në tarifa në vitin 2027.

Konsultimi publik është në thelb të politikave rregullatore të ZRRE-së. Gjatë procesit të konsultimit publik në kuadër të këtij procesi të përshtatjeve tarifore për vitin 2026, ZRRE ka pranuar komente nga një organizatë e Shoqërisë Civile – INDEP dhe nga pesë të licencuarit: KOSTT, KEDS, KESCO, KEK dhe Elektroserver:

- Aneksi A1 paraqet përgjigjet ndaj komenteve të INDEP;
- Aneksi A2 paraqet përgjigjet ndaj komenteve të ndërmarrjeve energjetike;



## **ANEKSI 1 Komente nga Shoqëria Civile – Organizata INDEP**

### ***Komenti 1.1***

Tre raportet e konsultimit për Vitin Tarifor 2026 janë të datës 10 prill 2026, me afat për komente deri më 24 prill 2026. Viti i ri tarifor konsiderohet të fillojë më 1 prill 2026, që do të thotë se procesi rregullator, përfshirë konsultimin publik dhe vendimin përfundimtar të bordit, nuk ka përfunduar para fillimit të vitit tarifor. Kjo nuk është një rast i izoluar.

ZRRE ka hapur zyrtarisht procesin e rregullimit vjetor më 12–15 dhjetor 2025. Operatorët e rregulluar kanë dorëzuar aplikimet e tyre deri në fund të janarit 2026. Më pas, ZRRE ka marrë rreth dhjetë javë për përgatitjen e raporteve të konsultimit, duke i publikuar ato pasi viti tarifor kishte filluar tashmë. Edhe për Vitin Tarifor 2025, vendimi i bordit (Vendimi V\_2696\_2025) është nxjerrë më 11 prill 2025, ndërsa aplikacioni i këtij viti i KEDS dokumenton se tarifrat e miratuara janë zbatuar vetëm nga muaji maj 2025 dhe jo nga prilli, siç ishte parashikuar, duke krijuar një hendek financiar të pranuar në tremujorin e parë të vitit 2025.

### **Shqetësimi**

Raportet e konsultimit të ZRRE-së për Vitin Tarifor 2026 janë publikuar pasi viti tarifor kishte filluar tashmë. Ky model i vendimeve të vonuara, i konfirmuar nga dokumentacioni i KEDS-it që tregon se tarifrat për vitin 2025 janë zbatuar vetëm nga maji i vitit 2025, përbën një dështim sistematik rregullator me pasoja të drejtpërdrejta financiare si për operatorët ashtu edhe për konsumatorët.

### **Përgjigja e ZRRE-së 1.1**

Pas dorëzimit të aplikacioneve nga të licencuarit (KOSTT, KEDS dhe KESCO), ZRRE ka vazhduar verifikimin dhe validimin e të dhënave duke përfshirë përditësimin e tyre me informatat e fundit në dispozicion. Me qëllim të vlerësimit dhe përshtatjes sa më të saktë të të Hyrave të Lejuara Maksimale për vitin 2026, ZRRE ka marrë përditësime të Bilancit të Energjisë. Duke përfshirë ndryshimet në disponueshmërinë e kapaciteteve gjeneruese të cilat kanë ndodhur gjatë muajit Mars dhe Prill. Këto përditësime të dhënave është dashur që të reflektohen në Modelet e të hyrave tarifave për të siguruar llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale sa më të sakta dhe të përditësuara.

Si rezultat i këtyre përditësimeve dhe si rezultat i profilizimit të kostove të blerjeve të enegjisë nga prodhimi vendor për një periudhë më të gjatë tarifore, të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2026 janë vlerësuar në nivelin që nuk do të ketë nevojë për rritje të tarifave aktuale për konsumatorët. Për rrjedhojë, zbatimi i tarifave të njejta për vitin tarifor 2026, nuk do të krijojë probleme financiare për operatorët e sitemit.

ZRRE është e përkushtuar që të zbatojë afatet kohore në lidhje me procesin e Përshtatjeve Vjetore të të Hyrave, megjithatë, në raste të caktuara, përditësimet e të dhënave dhe nevoja për saktësi më të lartë në vlerësime mund të kërkojnë kohë shtesë. Rëndësia e këtyre përditësimeve që marrin kohë më të gjatë, është më e rëndësishme se afatet kohore të paracaktuara. Gjithësesi ZRRE do të bëjë përpjekje maksimale për të përmbushur afatet kohore në proceset e ardhshme të Përshtatjeve të Rregullta Vjetore.



## ***Komenti 1.2***

Aplikimi i KEDS/OSSH-së identifikon në mënyrë eksplicite zbatimin e vonuar të tarifave të vitit 2025 si një burim të çekuilibrit financiar: të hyrat për tremujorin e parë të vitit 2025 janë mbledhur sipas tarifave të vitit 2024, ndërsa kostot janë bartur në nivelet e vitit 2025. Ky hendek pasqyrohet drejtpërdrejt në Faktorin e Rregullimit të të Hyrave (KREV), i cili më pas rikuperohet nga konsumatorët në vitet pasuese tarifore. Prandaj, vonesa rregullatore imponon një kosto të shtyrë për konsumatorët finalë pa asnjë përfitim përkatës në shërbim.

**INDEP rekomandon** që ZRRE-së të angazhohet publikisht për një kalendar procesi të detyrueshëm ligjërisht: raportet e konsultimit të publikohen deri më 1 shkurt dhe vendimi i Bordit të nxirret jo më vonë se 15 marsi i çdo viti, duke siguruar që tarifat të hyjnë në fuqi nga 1 prilli. Ky kalendar duhet të kodifikohet në Rregullat përkatëse të MAR-it dhe zbatimi i tij duhet t'i nënshtrohet auditimit ligjor.

INDEP ka kërkuar gjithashtu në të kaluarën një rishikim të plotë të kalendarit tarifor, në mënyrë që tarifat të mos rriten në muajin kur konsumi bie natyrshëm (për INDEP kjo konsiderohet në prag të një praktike mashtruese sipas nenit 9 të Ligjit Nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit). Megjithatë, përdërisa prilli mbetet muaji i fillimit, kalendarit tarifor duhet të respektohet pa asnjë vonesë!

### **Përgjigja e ZRRE-së 1.2**

Arsyet për afatet kohore janë dhënë në pikën 1.1 të përgjigjeve të ZRRE-së, kurse brengat financiare për të licencuarit pasqyrohen në faktorin në përshtatjes së të Hyrave (KREV) bazuar në vitin 2025.

Sa i përket kërkesës për respektimin e kalendarit, ZRRE përveç sqarimeve të dhëna në përgjigjen 1.1, thekson se kalendarit i Përshtatjeve Vjetore për HLM është i përcaktuar në Rregullat për të Hyrat Maksimale: për FSHU [Shtojca 3](#), për OST/OT [Shtojca 7](#) dhe për OSSH gjithashtu [Shtojca 7](#).

Gjithashtu, për kërkesën në lidhje me ndryshimin e kalendarit, ZRRE thekson se kalendarit është në pajtim me kornizën aktuale ligjore dhe rregullatore, pa ndryshimin e kësaj kornize nuk mund të ndryshohet kalendarit tarifor.

ZRRE thekson se përcaktimi i vitit tarifor (prill–mars) dhe struktura kohore e zbatimit të tarifave janë në përputhje me kornizën rregullative aktuale dhe nuk përbëjnë praktikë mashtruese, por reflektim të një cikli të standardizuar rregullator.

### ***INDEP komenti 1.3***

Periudha efektive e konsultimit prej 14 ditësh (10–24 prill) është e pamjaftueshme për një angazhim thelbësor nga organizatat e shoqërisë civile, shoqatat e konsumatorëve apo studiuesit e pavarur. Vetë raportet e konsultimit të ZRRE-së e pranojnë kompleksitetin e konsiderueshëm të vlerësimeve përkatëse. Një periudhë konsultimi më e shkurtër se dy javë nuk përmbush parimin e pjesëmarrjes kuptimplotë të publikut.

**INDEP rekomandon** një periudhë minimale prej 30 ditësh për komente në konsultimet HLM-së. ZRRE-ja duhet gjithashtu të shqyrtojë publikimin e një përmbledhje jo-teknike, të qasshme për konsumatorët e zakonshëm, që shpjegon faktorët kryesorë të kostos dhe ndikimin e tyre të pritshëm në faturat e energjisë.



### Përgjigja e ZRRE-së 1.3

Sa i përket afateve të konsultimit, ZRRE thekson se ato janë të përcaktuara në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, përkatësisht në Ligjin për Rregullatorin e Energjis [Neni 27](#).

ZRRE e pranon se kompleksiteti i çështjeve që trajtohen në Raportet Konsultative për të Hyrat e Lejuara Maksimale mund të kërkojë kohë shtesë për analizë nga palët e interesit. Për këtë arsye, ZRRE do të shqyrtojë mundësinë e zgjatjes së periudhës së konsultimit në proceset e ardhshme, në masën që kjo është e mundur brenda kufizimeve të kornizës ekzistuese rregullative dhe kohore.

#### **INDEP komenti 2.1 - KOSTT/OST/OT**

ZRRE propozon të Hyra Maksimale të Lejuara (MAR) për KOSTT prej 75.86 milionë euro për vitin 2026, krahasuar me kërkesën e KOSTT prej 99.38 milionë euro dhe 88.20 milionë euro të lejuara në vitin 2025. Reduktimet kryesore lidhen me kostot e shërbimeve ndihmëse, Fondin për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (RES) dhe kostot e prokurimit të humbjeve. INDEP në përgjithësi e mbështet këtë rezultat, por ngre shqetësime për disa çështje specifike.

**Table 1. INDEP komentet për KOSTT, propozimi për HLM**

Komponenti	Kërkesa e KOSTT	Propozimi ZRRE	Vlerësimi i INDEP
OPEX	€9.16m	€8.11m	Ulja është i justifikuar; tejkalimi i nivelit të lejuar të vitit paraprak kërkon monitorim.
Shërbimet Ndihmëse	€45.00m	€39.64m	Ulja mbështetet; nevojitet transparencë në prokurim.
Bleraje e Humbjeve	€15.76m	€12.11m	Parashikimi më i ulët i çmimit të energjisë nga ZRRE (93.14 € kundrejt 122.72 €/MWh) është i bazuar mirë.
Fondi BRrE	€18.68m	€6.85m	Ulja mbështetet fuqishëm; KOSTT nuk e ka përditësuar çmimin referencë. OPEX (rregullimi i KREV-it)
OPEX (KREV përshtatjet)		-€2.53m	Njohja më e kufizuar e kostove nga ZRRE është e përshtatshme.
HLM totale	€99.38m	€75.86m	INDEP e përkrah në përgjithësi



## **Përgjigja e ZRRE-së 1.2**

Ky koment ka të bëjë me disa vlerësime të përgjithëshme për të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) për KOSTT për vitin 2026, kurse komentet në vijim i specifikojnë këto vlerësime dhe INDEP jep disa rekomandime, në të cilat ZRRE varësisht nga komenti do i jep përgjigjet adekuate.

### ***INDEP komenti 2.2 – kostot e shërbimeve ndihmëse, transparenca dhe prokurimi***

KOSTT kërkoi 45.00 milionë euro për shërbime ndihmëse (rezervat aFRR dhe mFRR) për vitin 2026, kundrejt një kostoje të realizuar prej 39.64 milionë euro në vitin 2025. ZRRE propozon ta lejojë koston e realizuar të vitit 2025 si pikë referuese (benchmark) për vitin 2026. INDEP e mbështet këtë qasje si të përputhshme me parimin e rregullimit të kujdesshëm dhe të bazuar në kosto reale.

Megjithatë, INDEP vëren se KOSTT siguron rezervat aFRR ekskluzivisht nga operatori shqiptar i sistemit (OST Shqipëri) përmes ankandëve javore me çmim fiks kapaciteti, ndërsa mFRR nga KESH me kontratë. Kostoja aggregate e këtyre dy kontratave (përkatësisht 25.43 milionë euro dhe 14.21 milionë euro në vitin 2025) është e konsiderueshme dhe bie tërësisht mbi konsumatorët e energjisë elektrike. ZRRE duhet t'i kërkojë KOSTT-it të dëshmojë se prokurimi është zhvilluar në mënyrë konkurruese dhe se nuk janë anashkaluar alternativa me kosto më të ulët në periudhat përkatëse kontraktuese.

INDEP Rekomandon: ZRRE duhet t'i kërkojë KOSTT-it të publikojë raporte vjetore të prokurimit për shërbimet ndihmëse, përfshirë dëshmi të vlerësimit konkurrues, si kusht për rikuperimin e këtyre kostove përmes tarifës.

## **Përgjigja e ZRRE-së 2.2**

Në përcaktimin e kostove të lejuara për blerjen e energjisë së importuar, ZRRE ka adoptuar parimin që të përdoren të dhënat më të fundit mujore reale, që janë të disponueshme, ndërsa për periudhën e mbetur janë përdorur vlerësime të bazuara në koston reale të vitit paraprak.

Duke zbatuar të njëjtin parim, ZRRE ka rishikuar koston e lejuar për prokurimin e shërbimeve ndihmëse për të përfshirë koston reale për periudhën janar–mars 2026 dhe koston e parashikuara për muajt në vijim, përdorur si referencë koston reale të vitit 2025. Kostot e parashikuara mbeten të pandryshuara për muajt pasues (pra, janë të barabarta me vlerat reale të vitit 2025). Diferenca ndërmjet kostove reale të prokurimit për periudhën janar–mars 2026 krahasuar me janar–mars 2025 është 0.67 milion €, siç paraqitet më poshtë (Tabela 5). Kjo vlerë është paksa e ndryshme nga ajo e raportuar nga KOSTT, e cila krahason vlerat reale të vitit 2026 me vlerat e planifikuara nga KOSTT, dhe jo me vlerat reale të vitit 2025.

Sa i përket rekomandimit të INDEP, ZRRE thekson se KOSTT i dorëzon raportet, dëshmitë e prokurimit gjegjësisht kontratat për prokurimin-blerjen e shërbimeve ndihmëse dhe të njejtat duhet të jenë publike.

### ***INDEP komenti 2.3 – mosazhurnimi i çmimit referues***

Në aplikimin fillestar, KOSTT e përdori çmimin referues të vitit 2025 prej 65.12 €/MWh për llogaritjen e fondit mbështetës për BRE, në vend që ta përditësonte atë me vlerën e vitit 2026. ZRRE-së iu desh



ta udhëzojë KOSTT-in që ta zbatojë metodologjinë e vet, duke rezultuar me një çmim referues të përditësuar prej 88.58 €/MWh. Ky çmim referues më i lartë e ul ndjeshëm primin që u paguhet gjeneratorëve nga BRE, duke e zbritur fondin nga 18.68 milionë euro të propozuara fillimisht në 6.85 milionë euro.

**INDEP Shqetësimi:** Dështimi i KOSTT-it për ta zbatuar metodologjinë e vet rregullatore në aplikimin fillestar, qoftë për shkak të neglizhencës apo interesit komercial, kërkoi ndërhyrjen e ZRRE-së. Kjo ngre pikëpyetje për cilësinë e proceseve të brendshme të pajtueshmërisë rregullatore të KOSTT-it dhe, po të mos ishte kapur gabimi, do të rezultonte me mbipagesë prej afërsisht 11.83 milionë euro nga konsumatorët për të subvencionuar gjeneratorë që nuk kishin nevojë për atë mbështetje shtesë.

**INDEP Rekomandimi:** INDEP rekomandon që ZRRE të fusë një listë formale të validimit të aplikimeve, duke u kërkuar operatorëve të certifikojnë pajtueshmërinë me të gjithë parametrat aktualë metodologjikë para dorëzimit. Gabimet që i fryjnë materialisht kërkesat për të hyra duhet të regjistrohen dhe raportohen në raportin vjetor të performancës rregullatore të ZRRE-së.

### **Përgjigja e ZRRE-së 2.3**

Gjatë proceseve të shqyrtimeve të rregullta tarifore, si dhe gjatë procesit të përshtatjeve vjetore për të caktuar HLM. ZRRE i ka të përgatitura Modelet e të hyrave, të tarifave të standardizuara (në Excel), të cilat u dërgohen të licencuarve. Këto modele plotësohen nga të licencuarit dhe dorëzohen të ZRRE së bashku me aplikimin për HLM. Të dhënat e plotësuara në këto modele janë lehtë të verifikueshme nga ZRRE, ngase janë të bazuara në formula të cilat janë pjesë e Rregullave të aprovuara nga ZRRE. Pra, ZRRE gjithmonë kontrollon dhe vërteton saktësinë e të dhënave në përputhshmëri me metodologjinë në fuqi, gjithashtu kontakton të licencuarit për të marrë sqarime shtesë ose verifikim të të dhënave të paraqitura. Për sqarime, gabimet eventuale, ZRRE reflekton vlerat e sakta në llogaritjet përfundimtare, siç ka ndodhur edhe në këtë rast me përditësimin e çmimit referues për vitin 2026.

### ***INDEP Komenti 2.4 - Investimet kapitale: nënshpenzimi dhe kërkesat për projekte të reja***

ZRRE gjeti se shpenzimet kapitale të KOSTT-it gjatë viteve 2023–2024 kanë qenë dukshëm nën nivelet e miratuara. Pavarësisht kësaj, KOSTT kërkoi shtimin e shtatë projekteve të reja kapitale (me vlerë të përgjithshme të vlerësuar: rreth 19.6 milionë euro) në aplikimin e tij MAR për vitin 2026. ZRRE me të drejtë refuzoi t'i njohë projektet që nuk janë përfshirë në planet e miratuara zhvillimore, duke rezervuar mundësinë që ato të inkorporohen në periudhat e ardhshme rregullatore pasi të përfshihen në Planin Dhjetëvjeçar Zhvillimor.

INDEP e mbështet këtë vendim. Kombinimi i nënshpenzimit sistematik kundrejt planit të miratuar të investimeve dhe kërkesave për shpenzime kapitale shtesë të paplanifikuara përbën shqetësim për qeverisjen rregullatore. KOSTT po ashtu mban një bilanc të konsiderueshëm të parasë së gatshme, ndërkohë që shfrytëzon linja kreditore të BERZH-it, gjë që ZRRE duhet ta marrë parasysh në vlerësimin e saj të Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit (WACC) në rishikimin e ardhshëm periodik.

**INDEP Shqetësimi:** Rrjedhja e vazhdueshme e gazit SF6 në NS Palaj (e identifikuar në korrik 2024) paraqet një rrezik të pazgjidhur mjedisor dhe për shëndetin në punë. SF6 është një gaz serrë shumë i



fuqishëm me potencial dëmtues për ngrohjen globale 23,500 herë më të lartë se CO<sub>2</sub>. Aplikacioni i KOSTT-it e trajton këtë si një projekt të vogël kapital (projekt prej 150,000 euro) pa afat të deklaruar për përfundim. Kjo është e pamjaftueshme!

**INDEP Rekomandimi:** ZRRE duhet ta kushtëzojë miratimin e projektit NS Palaj me dorëzimin nga KOSTT të një afati detyrues për sanim, me raportim mujor të progresit, dhe duhet t'i kërkojë KOSTT-it të kuantifikojë emetimet kumulative të SF<sub>6</sub> nga rrjedhja si pjesë e detyrimeve të tij mjedisore. Kjo është kruciale që procesi tarifor të kontribuoj gjithashtu në mbrojtjen e mjedisit dhe sanimin e dëmeve sipas parimit 'ndotësi paguan'.

#### **Përgjigja e ZRRE-së 2.4**

ZRRE vlerëson qëndrimin e INDEP lidhur me trajtimin e investimeve kapitale dhe thekson se refuzimi i projekteve që nuk janë pjesë e planeve të miratuara zhvillimore është në përputhje me kornizën rregullatore në fuqi. Projekte të tilla mund të konsiderohen në periudhat e ardhshme rregullatore, pasi të përfshihen në dokumentet përkatëse planifikuese. Gjithashtu, duke analizuar shqetësimin e INDEP në lidhje në rrjedhën e vazhdueshme të gazit SF<sub>6</sub> në NS në Palaj, ZRRE inkurajon KOSTT që ky projekt të zbatohet në kohë sa më të arsyeshme, në përputhje me kërkesat teknike dhe të sigurisë. Sa i përket rekomandimit për kuantifikimin e emetimeve kumulative të SF<sub>6</sub> nga rrjedhja si pjesë e detyrimeve të KOSTT-it për çështje mjedisore, këto janë obligime të Ministrisë përgjegjëse për mjedisin. Vlen të theksohet se, ZRRE gjatë takimeve me KOSTT-in ka inkurajuar që projektet me rëndësi të veçantë të përfshihen në planet përkatëse zhvillimore, me qëllim të trajtimit të tyre në kohë, duke përfshirë edhe projektet e përmendura tjera në kuader të këtij dokumenti.

#### ***INDEP Komenti 2.5 - Kostot e prokurimit të humbjeve***

INDEP e mbështet vendimin e ZRRE-së për të aplikuar një çmim më të ulët të parashikuar për blerjen e energjisë (93.14 €/MWh kundrejt 122.72 €/MWh të KOSTT-it) për prokurimin e humbjeve të transmetimit. Metodologjia e ZRRE-së, e bazuar në të dhënat e përditësuara të tregut ALPEX dhe në çmimet reale të janarit–shkurtit 2026, prodhon një vlerësim më të besueshëm. Diferenca rezulton në kursim prej 3.65 milionë euro, gjë që në fund i mbron konsumatorët nga kostot e fryra që barten në tarifë.

INDEP Opinioni: Korrigjimi nga ZRRE i parashikimit të kostos së prokurimit të humbjeve të KOSTT-it është metodologjikisht i qëndrueshëm dhe qasje mbrojtëse për konsumatorin. INDEP e vlerëson këtë qasje dhe rekomandon që ajo të standardizohet në të gjithë operatorët.

#### **Përgjigja e ZRRE-së 2.5**

ZRRE e vlerëson opinionin e INDEP në lidhje me vendimin e ZRRE-së për çmimin e blerjes së energjisë për humbje.



ZRRE thekson se metodologjia e aplikuar bazohet në të dhënat më të fundit të tregut dhe në çmimet reale të disponueshme, me qëllim sigurimin e një vlerësimi sa më realist dhe të qëndrueshëm të kostove. Kjo qasje synon të shmangë mbivlerësimin e kostove dhe të mbrojë konsumatorët nga bartja e kostove të panevojshme në tarifa.

### **INDEP komenti 3.1 - KEDS/OSSH: Operatori i Sistemit të Shpërndarjes**

ZRRE propozon MAR për KEDS-in në vlerë prej 184.75 milionë euro për vitin 2026, kundrejt kërkesës së KEDS-it prej 235.38 milionë euro. Uljet kryesore kanë të bëjnë me kostot e blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve, shpenzimet operative dhe faktorin KREV të korrigjimit të të hyrave. Kjo paraqet përshtatjen më të madhe absolute ndërmjet tre operatorëve dhe meriton shqyrtim të detajuar.

**Table 2. INDEP comments on KEDS / OSSH proposed MAR**

Komponenti	Kërkesa e OSSH	Propozimi ZRRE	Vlerësimi i INDEP
OPEX	€39.39m	€32.75m	Lejimi i pjesshëm i rritjeve të pagave mbështetet; kërkojmë transparencë në shpërndarje
Humbjet e energjisë	€107.41m	€80.75m	Çmimi më i ulët i importit nga ZRRE (129.76 € kundrejt 151.31 €/MWh) është i justifikuar
Norma e lejuar e humbjeve (2026)	13.85%	12.79%	INDEP e mbështet trajektoren e vazhdueshme të uljes
KREV (korrigjimi për vitin 2025)	€41.86m	€30.11m	Njohja më e kufizuar e kostove nga ZRRE është e përshtatshme
Humbjet në veri të Kosovës	N/A	18.5%	Lejimi më i lartë pranohet; nevojitet transparencë për progresin
MAR gjithsej	€235.38m	€184.75m	INDEP e mbështet në përgjithësi

### **Përgjigjja e ZRRE-së 3.1**

Ky koment ka të bëjë me vlerësime të përgjithëshme të të Hyrave të Lejuara Maksimale (HLM) për OSSH (KEDS) për vitin 2026, kurse komentet në vijim i specifikojnë këto vlerësime.



### **INDEP komenti 3.2 - OPEX dhe kostot e personelit**

Shpenzimet operative të KEDS-it për vitin 2025 në vlerë prej 36.48 milionë euro tejkalojnë shumën e lejuar prej 29.25 milionë euro me 7.23 milionë euro. KEDS ia atribuon këtë kryesisht presionit të pagave që vjen nga rritja e pagës minimale (nga 170 €/muaj në vitin 2022 në 425 €/muaj nga janari 2026 dhe 500 €/muaj nga korriku 2026), si dhe kërkesave operative të liberalizimit të tregut. ZRRE propozon 32.75 milionë euro për vitin 2026, duke përfshirë rritje të kostos së personelit.

prej 2.574 milionë euro dhe 0.31 milionë euro për shërbimet e kontraktuara të prekura nga rritja e pagës minimale. Qëndrimi i INDEP-it për këtë çështje është ky: ne pranojmë se hendeku i dokumentuar i pagave ndërmjet inxhinierëve dhe teknikëve të KEDS-it dhe homologëve të tyre në KOSTT dhe KEK (inxhinierët: 845 € kundrejt 980–971 €; teknikët: 650 € kundrejt 699–747 €) përbën një rrezik legjitim të mbajtjes së stafit, i cili pjesërisht është jashtë kontrollit të KEDS-it. Rritjet e pagës minimale janë vendime qeveritare të cilat KEDS nuk mund t'i neglizhojë.

Megjithatë, INDEP është i shqetësuar se rregullimet e pagave të miratuara përmes tarifave mund të favorizojnë në mënyrë disproporcionale stafin menaxherial e jo atë operativ. Vetë raporti i ZRRE-së rekomandon që shtesa e lejuar duhet “t’i japë përparësi mbajtjes së stafit profesional dhe teknik” dhe të shmangë rritjet disproporcionale në nivelet menaxheriale. Ky rekomandim duhet të jetë i detyrueshëm.

**INDEP Rekomandon:** ZRRE duhet t’i kërkojë KEDS-it të dorëzojë një raport vjetor të shpërndarjes së pagave, të zbërthyer sipas kategorive të punës (menaxhment / inxhinierë të lartë / inxhinierë operativë / teknikë / staf terreni), si kusht për rritjen e lejitimit të OPEX-it. Çdo rishikim i ardhshëm i OPEX-it duhet të vlerësojë nëse rregullimi i miratuar i pagave ka arritur te përfituesit e synuar. Pagat në KEDS duhet të reflektojnë ato të tregut (psh të KOSTT) por duke reflektuar nivelin e tyre sipas të gjitha pozitave.

### **Përgjigja e ZRRE-së 3.2**

ZRRE ashtu si është konstatuar edhe në komentin e INDEP ka kërkuar nga KEDS “t’i japë përparësi mbajtjes së stafit profesional dhe teknik” dhe të shmangë rritjet disproporcionale në nivelet menaxheriale. Në këtë drejtim, ZRRE tashmë ka kërkuar nga KEDS që shtesat e lejuara të orientohen kryesisht drejt këtyre kategorive kritike të stafit. Sa i përket rekomandimit, ZRRE njofton se pranon raporte nga të licencuarit për të gjitha shpenzimet operative përfshirë koston për paga, gjithashtu ZRRE do të aprovoj kërkesat e arsyeshme për kostot e pagave për të reflektuar inflacionin dhe barazinë në nivelin e pagave të sektorit.

### **INDEP komenti 3.3 - Ulja e humbjeve**

Për herë të parë që nga privatizimi, KEDS e arriti normën e lejuar të humbjeve: humbjet reale të vitit 2025 ishin 14.06% kundrejt 14.28% sa ishin lejuar. INDEP e njuh këtë si një arritje domethënëse operative dhe e inkurajon ZRRE-në ta njohë formalisht këtë në vendimin përfundimtar. Trajektorja zbritëse e humbjeve e përcaktuar për vitin 2026 (12.79%) është ambicioze, por e besueshme duke pasur parasysh këtë përmirësim bazë.



**Opinion i INDEP:** Arritja nga KEDS e caktimit rregullator të humbjeve për herë të parë është një moment i vërtetë historik për efikasitetin operacional dhe mirëqenien e konsumatorit. INDEP i bën thirrje ZRRE-së ta njohë formalisht këtë në vendimin përfundimtar dhe të vlerësojë nëse mekanizmat nxitës në kuadrin aktual rregullator kanë qenë efektivë në nxitjen e këtij përmirësimi.

### **Përgjigja e ZRRE-së 3.3**

ZRRE e vlerëson opinionin e INDEP për arritjen dhe tejkalimin e caktimit të humbjeve nga KEDS, si zhvillim pozitiv në drejtim të përmirësimit të efikasitetit operacional dhe mbrojtjes së interesit të konsumatorëve. Konsistenca e ZRRE-së arritjen e caktimit të humbjeve, si dhe miratimi i projekteve investive të OSSH-së që kanë qenë në funksion të zvogëlimit të humbjeve, ka rezultuar me arritjen dhe tejkalimin e caktimit të humbjeve.

### ***INDEP komenti 3.4 - Veriu i Kosovës: lejimi i humbjeve dhe transparenca***

ZRRE aplikon një lejim dukshëm më të lartë të humbjeve për katër komunat veriore (18.5% për vitin 2026, nga 21.5% në vitin 2025) krahasuar me pjesën tjetër të vendit (~12.10%). Kjo pasqyron nëninvestimin historik dhe strukturën specifike kontraktuese që përfshin Elektroseverin. KEDS po investon 1.76 milionë euro në këtë rajon për vitin 2026.

Edhe pse INDEP e kupton arsyetimin, trajtimi i vazhdueshëm diferencial i konsumatorëve në veri, të cilët në praktikë subvencionojnë lejimet më të larta të humbjeve përmes tarifës, kërkon një udhërrëfyes rregullator më të qartë. Raporti i ZRRE-së jep informata të kufizuara se kur dhe si rrjeti në veri do të barazohet kundrejt standardeve kombëtare të humbjeve.

**INDEP Rekomandon:** ZRRE të publikojë një plan specifik shumëvjeçar për uljen e humbjeve në komunat veriore, duke vendosur caqe vjetore dhe duke kushtëzuar lejimin më të lartë të humbjeve me realizimin e dëshmuar të investimeve. INDEP po ashtu kërkon që ZRRE të sqarojë se si monitorohet dhe verifikohet ulja e humbjeve në veri, duke pasur parasysh se shërbimet e faturimit dhe matjes operohen nga Elektroseveri dhe jo nga KEDS-i.

### **Përgjigja e ZRRE-së 3.4**

Konsumatorët në veri të Kosovës për një kohë të gjatë janë furnizuar nga operatorë të palicencuar, si dhe nuk kanë paguar për shpenzimet e energjisë elektrike. Me fillimin e zbatimit të marrëveshjes së energjisë të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, furnizimi i konsumatorëve në veri të Kosovës bëhet nga operatorë të licencuar nga ZRRE. Sistemi i shpërndarjes së energjisë, përfshirë sistemin e matjeve nuk ka qenë i mirëmbajtur dhe nuk ka operuar në pajtim me kodet dhe kërksat teknike dhe rregullatore. Kjo vonesë ka si pasojë nivelin më të lartë të humbjeve në këtë zonë. Për këto arsye, ZRRE ka kërkuar një plan të redukimit të humbjeve, duke e kushtëzuar atë me realizimin e investimeve ku KEDS si pronare e aseteve të sistemit të shpërndarjes në këtë zonë ka përgatitë planin për redukimin e humbjeve. Duke marrë parasysh gjendjen e sistemit të shpërndarjes në këtë zonë, ZRRE ka lejuar një nivel më të lartë të humbjeve, por ka caktuar caqe reale të redukimit të humbjeve në vitet në vijim. Gjithashtu, ZRRE ka aprovuar projekte në Planet Zhvillimore dhe Investive të KEDS-it të cilat janë në funksion të zvogëlimit të humbjeve.



Sa i përket planit për redukimin e humbjeve, ai është në Cakun për Redukimin e Humbjeve në Shqyrtimin e tretë periodik i vlerave hyrëse [2023 - 2027](#).

**Monitorimi i të dhënave nga Elektroserver është përgjegjësi e KEDS-it sipas kontratës që e ka me Elektroserver dhe këto të dhëna dorëzohen nga KEDS te ZRRE.**

### ***INDEP komenti 3.5 - Tejkalimi i kostos së importit dhe rreziku i parashikimit të gjenerimit***

KEDS shpenzoi 16 milionë euro më shumë sesa ishte lejuar për importin e energjisë në vitin 2025, kryesisht për shkak se gjenerimi vendor nga termocentralet Kosova A dhe B mbeti nën parashikime, duke imponuar blerje emergjente me çmime të tregut. Ky tejkalim bartet te konsumatorët e vitit 2026 përmes mekanizmit KREV (duke kontribuar në faktorin korigjues prej 30.11 milionë euro).

Ky është një problem strukturor: konsumatorët bartin koston e performancës së pamjaftueshme të gjenerimit vendor përmes faturës së importit të operatorit të shpërndarjes. KEDS nuk mund ta kontrollojë prodhimin e KEK-ut, megjithatë tarifa e tij penalizohet kur KEK-u performon nën pritje. Kuadri rregullator i ZRRE-së duket se nuk përmban ndonjë mekanizëm që kërkon nga KEK-u t'i kompensojë operatorët (dhe përfundimisht konsumatorët) për pasojat në kosto që vijnë nga gjenerimi nën plan.

**INDEP shqetësimi:** Transferimi sistematik i kostove nga mungesat në gjenerimin e KEK-ut te konsumatorët përmes faturës së importit të KEDS-it është një pabarazi strukturore. Konsumatorët po paguajnë për një dështim performance që është tërësisht jashtë kontrollit të operatorit të shpërndarjes.

**INDEP Rekomandon:** ZRRE të iniciojë një rishikim të ndarjes së kostove përgjatë zinxhirit të vlerës, duke shqyrtuar posaçërisht nëse mungesat në gjenerimin e KEK-ut, të cilat shkaktojnë kosto të tepërta importi për KEDS dhe KESCO, duhet t'u nënshtrohen mekanizmave të përgjegjësive rregullatore, përfshirë kompensimin që duhet të paguhet nga KEK-u për licencat e prekura. Kjo është ndër pikat e vetme ku ZRRE duhet të komunikoj me Qeverinë si ushtruese e të drejtave të aksionarit në KEK.

### **Përgjigja e ZRRE-së 3.5**

ZRRE pajtohet me konstatimet e paraqitura nga INDEP në pjesën e parë të komentit, mirëpo, thekson se në bazë të kornizës ligjore dhe rregullative në fuqi, prodhimi i energjisë nuk është aktivitet i rregulluar. KEK dhe KESCO (FSHU) rregullohen përmes Marrëveshjes për Furnizim me Shumicë (BSA), e cila e rregullon çmimin dhe obligimet e dyanëshme. Në bazë të kësaj marrëveshje, KEK-u është i obliguar që tërë sasinë e prodhimit që është për konsumatorët me furnizim universal t'a jep KESCO si operator i licencuar i Furnizuesit për Furnizim Universal.

Në këtë kuadër, çdo devijim ndërmjet prodhimit të planifikuar dhe atij real reflektohet në nevojën për importe shtesë, të cilat trajtohen në përputhje me mekanizmat rregullatorë ekzistues, përfshirë faktorin e përshtatjes se kostove KREV, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së furnizimit.

Shqetësimi dhe rekomandimi i INDEP në lidhje me ndarjen e kostove kërkon ndryshim të kornizës ligjore dhe rregullatore.



### **INDEP komentimi 3.6 - Ndërprerjet operative dhe cilësia e shërbimit**

Aplikimi i KEDS-it dokumenton kërkesa sistematike ad-hoc për menaxhim të ngarkesës nga KOSTT në rajonet e Gjilanit, Prizrenit dhe Gjakovës për shkak të kongestionit në rrjet. KEDS përshkruan staf që punon me orar të zgjatur dhe jashtë orareve normale për t'i menaxhuar këto situata. Kjo dhe raste si ajo e ndërprerjeve si pasojë e dështimit për nominim, tregojnë për ndalje të vazhdueshme të furnizimit në rajone të caktuara, të cilat nuk pasqyrohen në asnjë kornizë të raportimit rregullator që aktualisht shihet në dokumentet konsultative të ZRRE-së. As raporti konsultativ i ZRRE-së dhe as aplikimi i KEDS-it nuk përmbajnë të dhëna për SAIDI (indeksi mesatar i kohëzgjatjes së ndërprerjeve), SAIFI (indeksi mesatar i frekuencës së ndërprerjeve), apo metrika të tjera të besueshmërisë së furnizimit. Nuk jepet asnjë mekanizëm kompensimi për konsumatorët. Ky është një boshllëk themelor në kuadrin rregullator.

**INDEP shqetësimi:** Konsumatorët në Gjilan, Prizren dhe Gjakovë po përjetojnë ndërprerje të furnizimit mbi mesataren. Procesi rregullator nuk parashikon matjen e kësaj, raportimin mbi të, apo kompensimin e konsumatorëve të prekur. Kjo është në kundërshtim me obligimet e Kosovës sipas acquis të Komunitetit të Energjisë dhe me praktikën më të mirë rregullatore.

#### **Përgjigjja e ZRRE-së 3.6**

ZRRE pajtohet me brengën e ngritur nga INDEP për ndërprerjet në furnizim për konsumatorët në zonat e theksuara. Sa i përket Standardeve të cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike, ZRRE thekson se ky aktivitet dhe monitorim i rregullt, ku raportohen të dhëna në mënyrë periodike për indikatorët SAIDI, SAIFI dhe ENS (energji e pafurnizuar) raportohen nga operatorët e sistemit dhe të njëjtat paraqiten në raportet vjetore të ZRRE-së, ashtu si janë paraqitur në [Raportin Vjetor – 2024](#). Gjithashtu. Operatori i Sistemit të Shpërndatjes KEDS e ka të aprovuar nga ZRRE Rregullën për [Standardet e Cilësisë të Shërbimit të Energjisë Elektrike](#). Për shkak të brishtësisë të sistemit, sistemi i kompenzimit kërkon një vlerësim të kujdesshëm të kushteve të sistemit dhe implikimeve rregullatore i cili ende nuk është miratuar, por mbetet objekt i shqyrtimit në kuadër të zhvillimeve të ardhshme rregullatore.

#### **INDEP komentimi 4.1 KESCO/FSHU - Përmbledhje e vlerësimit të ZRRE-së**

ZRRE propozon MAR për KESCO-n në vlerë prej 442.26 milionë euro për vitin 2026, kundrejt kërkesës së KESCO-s prej 528.78 milionë euro. Uljet kryesore lidhen me kostot e blerjes së energjisë me shumicë (parashikimi i çmimit të importit) dhe me faktorin KREV të korrigjimit të të hyrave. Ky është MAR-i më i madh ndër tre operatorët dhe përcakton pjesën më të madhe të niveleve të tarifave të energjisë elektrike për familjet.



**Table 3.** Komentet e INDEP për KESCO/propozimi për HLM-në e FSHU-së

Komponenti	Kërkesa e FSHU	Propozimi ZRRE	Vlerësimi i INDEP
OPEX	€229.04m	€177.81m	Çmimi më i ulët i importit nga ZRRE është i justifikuar; mekanizmi i profilizimit mbron konsumatorin
Humbjet e energjisë	€110.15m	€78.04m	34 milionë € të shtyra për vitin 2027, INDEP shpreh shqetësim për transparencën
Norma e lejuar e humbjeve (2026)	€157.84/MWh	€129.76/MWh	Parashikimi i harmonizuar i ZRRE së është më mirë i argumentuar
KREV (korrigjimi për vitin 2025)	€10.29m	€8.19m	Ulja është e përshtatshme
Humbjet në veri të Kosovës	€49.69m	€48.30m	Bartje e madhe e përsëritur, problem strukturor
MAR gjithsej	€528.78m	€442.26m	INDEP e mbështet këtë me rezerva

#### **Përgjigjja e ZRRE-së 4.1**

Ngjashëm si me operatorët tjerë ky koment ka të bëjë me vlerësimet e përgjithëshem të INDEP për nivelin e propozuar të të Hyrave të Lejuara Maksimale (HLM) për FSHU për vitin 2026. Për komentet specifike në vijim, do të jepen përgjigjet adekuate.

#### ***INDEP komenti 4.2 - Mekanizmi i profilizimit të kostos, përfitim për konsumatorin me kërkesë për transparencë***

ZRRE propozon të shtyjë afërsisht 34 milionë euro të kostove të blerjes së energjisë nga KEK-u nga viti 2026 në vitet e ardhshme tarifore. Arsyeimi i deklaruar është mbrojtja e konsumatorëve nga një rritje e menjëhershme tarifore e shkaktuar nga rehabilitimi tetëmuor i njësisë B1 të TC Kosova B (duke reduktuar gjenerimin vendor) me çmime të larta të importit. KESCO dhe KEK janë pajtuar në parim me këtë qasje.

INDEP e mbështet synimin e këtij mekanizmi: mbrojtja e konsumatorëve të cenueshëm nga një rritje e madhe tarifore brenda një viti të vetëm është në përputhje me mandatin tonë për mbrojtjen e konsumatorit. Megjithatë, mekanizmi përshkruhet vetëm në nivel të përgjithshëm në raportin konsultativ, pa specifikuar periudhën e rikuperimit ose koston financiare të shtyrjes (mbi shumën e papaguar llogaritet interes sipas EURIBOR + 5%).



**INDEP shqetësimi:** Përtej mungesës së detajeve financiare, INDEP vlerëson se mekanizmi i profilizimit të kostos ngre shqetësimet serioze në raport me parimet e pavarësisë rregullatore dhe transparencës së vendimmarrjes.

Duke qenë se viti 2026 përkon me një periudhë me probabilitet të lartë për zhvillime zgjedhore në Kosovë, shtyrja e një kostoje të konsiderueshme tarifore për vitet pasuese krijon perceptimin e një vendimi me ndikim të mundshëm politik, për të shmangur rritjen e tarifave në afat të shkurtër. Në këtë kontekst, mbetet e paqartë pse një mekanizëm i tillë nuk është aplikuar në vitet e mëparshme, pavarësisht luhatjeve të ngjashme në çmimet e importit dhe në disponueshmërinë e gjenerimit vendor. Po ashtu, mungon një sqarim i qartë mbi momentin dhe kushtet konkrete kur kjo kosto do të rikuperohet nga konsumatorët në vitet e ardhshme tarifore.

Më tej, nuk është bërë publik asnjë informacion nëse ka pasur komunikim formal apo joformal ndërmjet ZRRE-së dhe Qeverisë lidhur me këtë qasje, çka është thelbësore për të garantuar se vendimi është marrë ekskluzivisht mbi baza rregullatore dhe jo si rezultat i konsideratave të jashtme.

INDEP rekomndon: ZRRE të publikojë një profil të plotë financiar shumëvjeçar të kostos së shtyrë, duke treguar: (a) shumën e shtyrë; (b) koston e pritshme të interesit gjatë shtyrjes; (c) vitin/vitet tarifore në të cilat shuma do të rikuperohet; dhe (d) ndikimin e vlerësuar për familje në vitin e rikuperimit. Konsumatorët dhe palët e interesit kanë të drejtë ta dinë koston e plotë të këtij vendimi për zbutje tarifore.

Përtej kësaj, INDEP kërkon që ZRRE të sqarojë bazën rregullatore dhe arsyetimin specifik për aplikimin e këtij mekanizmi në vitin 2026, përfshirë pse një qasje e tillë nuk është përdorur në periudhat e mëparshme me kushte të ngjashme të tregut. ZRRE duhet gjithashtu të bëjë publik nëse ka pasur ndonjë komunikim formal apo joformal me Qeverinë lidhur me këtë vendim, në mënyrë që të garantohet transparenca e plotë dhe pavarësia e procesit rregullator.

#### **Përgjigja e ZRRE-së 4.2**

ZRRE vlerëson opinionin e INDEP për zbatimin e mekanizmi të profilizimit të propozuar nga ZRRE dhe të pajtuar në mes të KEK dhe KESCO, si një instrument të përshtatshëm për zbutjen e luhatjeve të menjëhershme tarifore, në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve. Kostot relevante në lidhje me këtë marrëveshje do të njihen nga ZRRE në Përshtatjet Vjetore në vitet në vijim.

ZRRE, thekson se qëllimi i këtij mekanizmi të profilizimit nuk është politik, por pragmatik. Me këtë mekanizëm evitohet rritja e tarifave për vitin 2026, si rezultat i reduktimit të gjenerimit vendor.

ZRRE thekson se detajet financiare lidhur me mekanizmin e profilizimit të kostos, përfshirë shumën e shtyrë, trajtimin e interesit dhe periudhën e rikuperimit, janë pjesë e marrëveshjes së arritur ndërmjet KEK dhe KESCO.

Sa i përket rekomandimit për parashikimin e çmimit të importit, ZRRE thekson se gjatë proceseve të Përshtatjeve Vjetore, si dhe Shqyrtimeve të Rregullta Tarifore i analizon parashikimet e publikuara të tregjeve të HUPLEX, ALPEX etj. Gjithashtu, operatorët e sitemit gjatë parashikimeve të çmimit të importit i referohen këtyre tregjeve.



### ***INDEP komenti 4.3 - Parashikimi i çmimit të energjisë me shumicë***

KESCO aplikoi çmime mesatare të importit prej 157.84 €/MWh në aplikimin e saj fillestar. Çmimet reale në janar dhe shkurt 2026 ishin 140.52 €/MWh përkatësisht 100.54 €/MWh, dukshëm më të ulëta se parashikimi. ZRRE e harmonizoi parashikimin në rënie në 129.76 €/MWh, duke prodhuar kursim prej afërsisht 14 milionë euro në komponentin e kostos së importit.

Kjo ilustron një problem të përsëritur: operatorët e rregulluar aplikojnë parashikime konservatore (të larta) të çmimit të importit, të cilat, nëse pranohen, do të rezultojnë në rikuperim të tepërt të kostove në dëm të konsumatorëve. Mekanizmi korigjues (KREV) i kthen shumat e rikuperuara tepër në vitet pasuese, por me një kosto financimi që në fund po ashtu bartet nga konsumatorët.

**INDEP rekomandon:** ZRRE të zhvillojë dhe publikojë një metodologji të standardizuar për parashikimin e çmimit të importit, të bazuar në të dhëna të vëzhgueshme të tregut nga HUPX, ALPEX dhe bursat e tjera rajonale, të cilën të gjithë operatorët e rregulluar do të jenë të detyruar ta përdorin. Kjo do t'i pengonte operatorët të aplikojnë vlerësime të posaçme (dhe sistematikisht të larta), do ta zvogëlonte madhësinë e korigjimeve të KREV-it dhe do ta përmirësonte parashikueshmërinë tarifore për konsumatorët.

### **Përgjigja e ZRRE-së 4.3**

ZRRE vlerëson opinionin e INDEP-it për ZRRE-n në lidhje me parashikimin e çmimeve të importit dhe uljen e tyre krahasuar me propozimin e KESCO.

Operatorët e sistemit në aplikimet e tyre paraqesin vlera të çmimeve të importit të bazuara në parashikimet nga tregjet e energjisë elektrike (PX), duke reflektuar edhe një qasje konservatore për të minimizuar, për tu siguruar që nuk do të kenë rreziqe financiare në rast të importit të energjisë. ZRRE i analizon këto parashikime, gjithashtu i merr parasysh çmimet e realizuara të importeve për muajt janar – mars të vitit në vijim dhe trendet deh parashikimet e këtyre çmimeve për muajt në vijim. Duke i bërë këto përditësime, ZRRE e bënë harmonizimin e këtyre çmimeve të cilat rezultojnë më të ulta se parashikimi i operatorëve të sistemit.

Në lidhje me rekomandimit, përgjigja është si më lartë në përgjigjen 4.2.

### ***INDEP komenti 4.4 Shqetësim strukturor: përshtatje të mëdha dhe të përsëritura të KREV-it***

KREV-i (Faktori i Korigjimit të të Hyrave) për KESCO-n arrin në 48.30 milionë euro vetëm për vitin 2026, duke pasqyruar hendekun ndërmjet të hyrave të lejuara për vitin 2025 dhe kostove reale. Vetë aplikimi i KESCO-s e pranon shprehimisht se “KREV-i ka bartur vlera të konsiderueshme nga viti në vit”, duke e quajtur këtë një sinjal se tarifat nuk i kanë reflektuar plotësisht kostot reale të furnizimit.

**INDEP Shqetësimi:** Mekanizmi KREV është projektuar për të parandaluar rikuperimin e përhershëm të tepërt ose të pamjaftueshëm, por shkalla e tij vjetore, 48.30 milionë euro në vitin 2026, ndërsa në një vit paraprak ishte 37.38 milionë euro, tregon një mospërputhje themelore ndërmjet parametrave të përdorur për përcaktimin e tarifave (veçanërisht supozimeve për disponueshmërinë e gjenerimit dhe parashikimeve të çmimit të importit) dhe rezultateve reale. Kjo mospërputhje është strukturale:



ajo buron nga optimizimi sistematik i tepruar për gjenerimin vendor dhe nënvlerësimi i rrezikut të importit.

**INDEP rekomandon:** ZRRE-së të porosisë një rishikim të pavarur të metodologjisë tarifore të FSHU-së, duke shqyrtuar posaçërisht nëse qasja aktuale për modelimin e disponueshmërisë së gjenerimit vendor dhe rrezikut të kostos së importit është e përshtatshme për qëllimin dhe nëse një margjinë rezervë e përshtatur sipas rrezikut në llogaritjen tarifore do ta zvogëlonte madhësinë e korrigjimeve vjetore të KREV-it.

#### **Përgjigja e ZRRE-së 4.4**

Faktori përshtatjes së të hyrave (ADJt), si faktor korrigjues i të hyrave në vitin relevant t llogaritet sipas formulës në [Rregulla për vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Sherbim Universal](#). ZRRE në përshtatjet vjetore e zbaton me saktësi formulën për KREV për të reflektuar dallimin në mes të hyrave të lejuara dhe kostove reale në vitin (t-1). ZRRE e kupton shqetësimin e INDEP, se për shkak të mungesave të paplanifikuara të prodhimit vendor, kostot e realizuara janë më të larta se ato të aprovuara nga ZRRE dhe kjo ndikon direkt në vlerën e përshtatjes së të hyrave.

Sa i përket rekomandimit, ZRRE gjithmonë është në kërkim të përmirësimit të metodologjisë tarifore, për të ju përshtatur kushteve dhe rrethanave të sektorit të energjisë, praktikat më të mira rregullatore dhe të tregut, por duhet vepruar në pajtim me kornizën ligjore dhe rregullatore në fuqi.

#### ***INDEP komenti 4.5 Liberalizimi i tregut dhe portofoli i shërbimit universal***

Sipas të dhënave më të fundit, 9,535 pika matëse, me konsum prej 1,119 GWh në vitin 2025, kanë kaluar në tregun konkurrues. Portofoli i shërbimit universal tani u shërben kryesisht konsumatorëve familjarë dhe bizneseve të vogla. Afati për daljen e detyrueshme të konsumatorëve jo-kualifikues nga shërbimi universal është shtyrë deri më 1 maj 2026.

INDEP e mbështet procesin e liberalizimit, por vëren se zbatimi i shpejtë në vitin 2025 krijoi ndërprerje operative dhe kosto të lidhura, të cilat tashmë janë të përfshira në OPEX-in dhe KREV in e KESCO-s. Në mënyrë kritike, disa konsumatorë fillimisht u klasifikuan gabimisht si jo kualifikues, më pas ky klasifikim u kthye mbrapsht, dhe ata përjetuan periudha pa furnizues të caktuar, duke u furnizuar përmes Furnizuesit të Mundësisë së Fundit. Ky lloj gabimi administrativ në një proces të mandatuar nga ZRRE nuk duhet të përsëritet, dhe pasojat e tij financiare nuk duhet të barten nga konsumatorët që nuk kishin asnjë rol në proces.

#### **Përgjigja e ZRRE-së 4.5**

ZRRE pajtohet me konstatimin e INDEP se në procesin e liberalizimit të tregut ka pasë probleme si në çdo proces i cili është fillestar me ndryshime strukturore ku janë paraqitur vështirësi operative dhe administrative. Me kalimin e kohës problemet janë zvogëluar dhe konsumatorët janë vendosur në kategorinë e duhur. Ky proces do vazhdojë të përmirësohet në këtë vit dhe vitet në vijim.



### ***INDEP koment 5.1 Mbrojtja e konsumatorit: një boshllëk strukturor në rregullimin energjetik të Kosovës - Pa rritje tarifore në vitin 2026, një bazë e mirëseardhur, por e pamjaftueshme***

INDEP vëren se nivelet e propozuara të MAR-it nga ZRRE për vitin 2026 nuk kërkojnë rritje tarifore për konsumatorët, pasojë e drejtpërdrejtë e rishikimeve në ulje që rregullatori ua ka bërë kërkesave të operatorëve në të tri entitetet. Ky është një rezultat pozitiv dhe ne e vlerësojmë qasjen e ZRRE-së. Megjithatë, mungesa e një rritjeje të çmimit nuk përbën mbrojtje të konsumatorit në kuptim gjithëpërfshirës. Konsumatorët kanë interesa legjitime në cilësinë e shërbimit, besueshmërinë e furnizimit, transparencën e faturimit dhe të drejtën për kompensim kur detyrimet e shërbimit nuk përmbushen. Asnjëra nga këto interesa nuk adresohet në procesin aktual të përshtatjes vjetore të MAR-it.

#### **Përgjigjja e ZRRE-së 5.1**

ZRRE pajtohet se mosrritja e tarifave nuk është masë e vetme për mbrojtjen e konsumatorëve, por në këtë kohë të rritjes globale të çmimeve të shumicës së shërbimeve dhe produkteve jetësore, paraqet një lehtësim për konsumatorët. Gjithësesi, ZRRE angazhohet në kontinuitet që përmes aprovimit të projekteve të paraqitura në Planet Zhvillimore dhe Investive të operatorëve të sistemit të përmirësohet cilësia e shërbimit, besueshmërinë e furnizimit, transparenca e faturimit për konsumator. Në lidhje me të drejtën e kompenzimit kur detyrimet e shërbimit nuk përmbushen, ZRRE thekson se mekanizmat janë gati, por zbatimi i tyre kërkon investime shtesë në sisteme, që kanë reflektim direkt në rritjen e tarifave për konsumator.

#### ***INDEP Komenti 5.2 - Standardet e cilësisë së shërbimit: të munguara në kuadrin rregullator***

INDEP i ka shqyrtuar në detaje të tri raportet konsultative dhe aplikimet përkatëse të operatorëve. Asnjë nga këto dokumente nuk përmban të dhëna mbi besueshmërinë e furnizimit, as SAIDI, as SAIFI, as statistika të ndërprerjeve sipas rajonit, as vëllim të ankesave të konsumatorëve, as norma të zgjidhjes së tyre. Procesi rregullator merret ekskluzivisht me parametrat financiarë.

Kjo nuk është thjesht një mungesë raportimi. Ajo sinjalizon se kuadri aktual rregullator energjetik i Kosovës nuk i mban operatorët formalisht përgjegjës për cilësinë e shërbimit të ofruar konsumatorëve. Operatorët mund të dështojnë në përmbushjen e standardeve të vazhdimësisë së furnizimit pa asnjë pasojë rregullatore brenda procesit tarifor.

**INDEP shqetësimi:** Ligji i Kosovës për Mbrojtjen e Konsumatorit u jep konsumatorëve të drejtën për kompensim kur detyrimet e shërbimit nuk përmbushen. ZRRE, si autoritet kompetent për standardet e shërbimit në sektorin e energjisë, ka mandatin dhe detyrimin ligjor të vendosë standarde detyruese minimale të cilësisë së shërbimit dhe mekanizma të kompensimit të konsumatorëve. Mungesa e standardeve të tilla është në kundërshtim me kuadrin ligjor të Kosovës dhe me obligimet nga Direktiva 2019/944 e Komunitetit të Energjisë.

#### **Përgjigjja e ZRRE-së 5.2**

Përgjigja në këtë koment është dhënë në përgjigjen më lartë 3.6, por ZRRE përsëritë se këto të dhëna të kërkuara për cilësinë e furnizimit si SAIDI, SAIFI, ENS, etj janë në Raportet Vjetore të ZRRE-së, andaj



kuadri rregulator nuk merret ekskluzivisht vetëm me parametra financiar por edhe me parametra të cilësisë së shërbimit. Gjithashtu, ZRRE i mbanë përgjegjës operatorët e sistemit për përmbushjen e standardeve.

Në lidhje me shqetësimin e paraqitur në këtë koment, ZRRE përseritë përgjigjen e dhënë në 3.6 se standarde detyruese minimale të cilësisë së shërbimit janë të miratuara nga ZRRE.

### ***INDEP komenti 5.3 - Shqetësime specifike për cilësinë e shërbimit të dokumentuara në aplikimet e vitit 2026***

Vetë aplikimet e operatorëve dokumentojnë dështime të vazhdueshme të shërbimit:

- KEDS raporton se rrjetet e ngarkuara në Gjilan, Prizren dhe Gjakovë kërkojnë menaxhim ditor manual të ngarkesës me kërkesë të KOSTT-it, duke nënkuptuar ndërprerje rutinore të furnizimit në këto rajone. Kostot e këtij operimi emergjent janë të përfshira në OPEX, por nuk ka raportim se sa konsumatorë preken, për sa kohë, apo me çfarë ndikimi financiar.
- KESCO dokumenton se konsumatorët mbetën pa një furnizues të caktuar gjatë periudhës së tranzicionit të tregut (gusht 2025), duke u detyruar të mbështeten te Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, me gjasë me kosto më të lartë. Nuk është aplikuar asnjë mekanizëm kompensimi për konsumatorët.
- Aplikimi i KOSTT-it dokumenton një rrjedhje gazi SF6 në NS Palaj, aktive që nga korriku 2024, një nënstacion që furnizon minierën Bardh i Madh dhe që është kritik për TC Kosova A dhe B. Një ndërprerje e zgjatur në këtë nënstacion do të kishte pasoja në të gjithë sistemin. Nuk përmendet asnjë njoftim për konsumatorët apo planifikim kontingjent.

### **Përgjigja e ZRRE-së 5.3**

- ZRRE i kupton shqetësimet e INDEP në lidhje me raportimet e KEDS për rrjetet e ngarkuar në Gjilan, Prizren dhe Gjakovë dhe menaxhimin ditor që duhet bërë për menaxhimin e kërke sës. KEDS raporton për numrin e konsumatorëve të ndikuar nga ndërprerjet si dhe për kohëzgjatjen, por për një raportim në kohë reale duhet sistem më i avancuar i menaxhimit të furnizimit të konsumatorëve SCADA, një sistem i tillë ka kosto shtesë e cila do të reflektohej në tarifat e konsumatorëve.
- Në kornizën aktuale rregullatore nuk ka mekanizëm të kompenzimit për konsumatorët që nuk kanë lidhur një kontratë furnizimi me një furnizues të licencuar dhe janë të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit nëse çmimi i këtij furnizimi është më i lartë se çmimi i furnizuesve të licencuar.
- ZRRE pajtohet që KOSTT duhet të marrë veprime për Nënstacionin në Palaj dhe kostot e këtyre veprimeve do ti pranohen në shqyrtimet tarifore, në përputhje me rregullat në fuqi.



#### **INDEP komenti 5.4 - Rekomandimet e INDEP-it për mbrojtjen e konsumatorit**

Për mbrojtjen e konsumatorëve INDEP jep këto rekomandime:

1. **STANDARDE DETYRUESE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT** - ZRRE duhet, brenda vitit 2026, të miratojë standarde minimale detyruese të cilësisë së shërbimit për KEDS-in (si operator i shpërndarjes), që mbulojnë: kohëzgjatjen maksimale vjetore të ndërprerjeve (SAIDI) për konsumator; frekuencën maksimale vjetore të ndërprerjeve (SAIFI); afatet e reagimit për rikthim të furnizimit pas ndërprerjeve; dhe afatet për zgjidhjen e ankesave. Shkeljet duhet të aktivizojnë kompensim automatik për konsumatorët pa kërkuar pretendime individuale.
2. **RAPORTE VJETORE PËR CILËSINË E SHËRBIMIT** - ZRRE duhet t'u kërkojë të tre licencuarve të publikojnë raporte vjetore për cilësinë e shërbimit së bashku me aplikimet e tyre MAR, të zbërthyer sipas rajonit dhe kategorisë së konsumatorit. Këto raporte duhet të inkorporohen në konsultimin publik.
3. **MEKANIZËM I KOMPENSIMIT TË KONSUMATORIT** - ZRRE duhet të vendosë një mekanizëm të standardizuar dhe automatik kompensimi, të modeluar sipas kornizave të krahasueshme evropiane, përmes të cilit konsumatorët marrin një pagesë fikse kompensimi për çdo ndërprerje që tejkalon pragjet e përcaktuara, e kredituar drejtpërdrejt në faturën e energjisë.
4. **MBROJTJA E KONSUMATORËVE TË CENUESHËM** - ZRRE duhet t'i kërkojë KESCO-s dhe KEDS-it të publikojnë një regjistër të konsumatorëve të cenueshëm dhe të dëshmojnë se veprimet e planifikuara për menaxhimin e ngarkesës, si ato të përshkruara në situatën Gjilan/Prizren/Gjakovë, përjashtojnë nga ndërprerjet e planifikuara infrastrukturën kritike sociale dhe konsumatorët familjarë të cenueshëm (p.sh. përdoruesit e pajisjeve mjekësore).

#### **Përgjigja e ZRRE-së 5.4**

Për rekomandimet 1,2,3 dhe 4 janë dhënë përgjigje më lartë por ZRRE përsëritë se:

1. Operatori i Sitemit të Shpërndarjes KEDS e ka të aprovuar nga ZRRE Rregullën për [Standardet e Cilësisë të Shërbimit të Energjisë Elektrike](#). Mekanizmi i kompenzimit nuk është në zbatim për shkak të brishtësisë së sistemit dhe kostove për zbatimin e këtij mekanizmi.
2. Raportet Vjetore të ZRRE-së dhe të operatorëve japin të dhëna për cilësinë e shërbimit
3. Mekanizmi i kompenzimit nuk është në zbatim për shkak të brishtësisë së sistemit dhe kostove për zbatimin e këtij mekanizmi.
4. Përgjigja e njejtë si në pikën 3



## Përmbledhje e rekomandimeve kryesore të INDEP-it

Table 4. Përmbledhje e rekomandimeve të INDEP-it

Nr.	Seksioni	Rekomandimi	Institucioni përgjegjës
1	Seksioni 1 – Procedurale	Vendosja e një kalendarit ligjërshët detyrues për procesin tarifor (raportet deri më 1 shkurt; vendimi deri më 15 mars) dhe auditimi i respektimit të tij	ZRRE
2	Seksioni 1 – Procedurale	Periudhë minimale 30-ditore për konsultimet MAR dhe publikimi i një përmbledhjeje jo teknike për konsumatorët	ZRRE
3	Seksioni 2 – KOSTT / OST	Publikimi i raporteve vjetore të prokurimit për shërbimet ndihmëse me dëshmi të konkurrencës si kusht për rikuperim tarifor	ZRRE / KOSTT
4	Seksioni 2 – KOSTT / OST	Vendosja e një liste formale të validimit të aplikimeve MAR dhe raportimi i gabimeve që fryjnë kërkesat	ZRRE
5	Seksioni 2 – KOSTT / OST	Kushtëzimi i projektit NS Palaj me afat detyrues për sanim, raportim mujor dhe kuantifikim të emetimeve SF6	ZRRE / KOSTT
6	Seksioni 3 – KEDS / OSSH	Raport vjetor i shpërndarjes së pagave sipas kategorive të stafit si kusht për rritjen e OPEX-it	ZRRE / KEDS
7	Seksioni 3 – KEDS / OSSH	Publikimi i një plani shumëvjeçar për uljen e humbjeve në veri me caqe dhe mekanizma monitorimi/verifikimi	ZRRE
8	Seksioni 3 – KEDS / OSSH	Rishikimi i ndarjes së kostove në zinxhir (përfshirë përgjegjësinë e KEK për mungesat në gjenerim)	ZRRE
9	Seksioni 4 – KESCO / FSHU	Publikimi i profilit të plotë financiar shumëvjeçar të kostos së shtyrë (shuma, interesi, vitet e rikuperimit, ndikimi për familje)	ZRRE / KESCO
10	Seksioni 4 – KESCO / FSHU	Sqarimi i bazës rregullatore për mekanizmin e shtyrjes dhe publikimi i çdo komunikimi me Qeverinë	ZRRE
11	Seksioni 4 – KESCO / FSHU	Zhvillimi i një metodologjie të standardizuar për parashikimin e çmimeve të importit	ZRRE
12	Seksioni 4 – KESCO / FSHU	Rishikim i pavarur i metodologjisë tarifore të FSHU për të adresuar problemin strukturor të KREV	ZRRE
13	Seksioni 5 – Mbrojtja e Konsumatorit	Vendosja e standardeve detyruese të cilësisë së shërbimit (SAIDI, SAIFI, rikthimi i furnizimit, ankesat) me kompensim automatik	ZRRE
14	Seksioni 5 – Mbrojtja e Konsumatorit	Publikimi i raporteve vjetore për cilësinë e shërbimit nga të gjithë operatorët	ZRRE / Operatorët
15	Seksioni 5 – Mbrojtja e Konsumatorit	Vendosja e një mekanizmi të standardizuar automatik të kompensimit për konsumatorët	ZRRE
16	Seksioni 5 – Mbrojtja e Konsumatorit	Krijimi i regjistrit të konsumatorëve të cënueshëm dhe përjashtimi i tyre nga ndërprerjet jo thelbësore	ZRRE / KEDS / KESCO



## **Përgjigja e ZRRE-së përmbledhje të rekomandimeve**

Për rekomandimet 1 -16, përgjigjet janë dhënë në përgjigjet më lartë, por ZRRE përsëritë:

1. Ekziston Korniza rregullatore për kalendarin për procesin tarifor
2. Kohëzgjatja e konsultimit publik është e caktuar në kornizën ekzistuese rregullatore
3. Në pajtim me kornizën ligjore dhe rregullatore
4. Modelet e HLM-vë janë në përdorim ku mund të identifikohen dhe korrigjohen gabimet eventuale
5. ZRRE e inkurajon KOSTT-in për këtë projekt, kurse kuantifikimi i emetimeve është përgjegjësi e Ministrisë së Mjedisit
6. ZRRE pranon nga KEDS raporte për shpërndarje të pagave
7. Planet për uljen e humbjeve janë të aprovuara për OST dhe OSSH
8. Ndarja e kostove sipas Rregullave për sektorin e rregulluar
9. Kontrata KEK – KESCO mund të publikohet përgjegjësi e paleve nënshkruese
10. Mekanizmi i aplikuar është në përputhje me kornizën rregullatore, vendimarrja është e pavarur dhe transparente, kurse komunikimet me qeverinë janë publike
11. Parashikimi i çmimeve të importit bazohet në analizën e tregjeve relevante të energjisë dhe të dhënave reale të disponueshme
12. Ekziston metodologjia tarifore, përmirësimet mund të parashihen në përputhje me zhvillimet në sektor
13. Janë të vendosura në Rregullën e KEDS-it për Standardet e Cilësisë
14. Raportet Vjetore të ZRRE-së dhe Raportet e Operatorëve
15. Në të ardhmen kur të krijohen kushtet
16. Çështja e konsumatorëve të cenueshëm trajtohet përmes mekanizmave dhe regjistrave ekzistues, me mundësi për përmirësime të mëtejshme.



## ANEKSI 2 Përgjigje ndaj komenteve të ndërmarrjeve energjetike

### A2.1 KOSTT (OST/MO)

Komentet e pranuar nga KOSTT paraqiten më poshtë, së bashku me përgjigjet e ZRRE-s. Komentet janë përmbledhur dhe nuk janë paraqitur fjalë për fjalë.

#### A2.1.1 *Kostoja e blerjes së humbjeve në transmetim*

##### **Koment**

KOSTT konsideron se çmimet e parashikuara për energjinë e përdorur për mbulimin e humbjeve nga muaji prill e tutje janë nënvlerësuar. Parashikimi bazohet në mesataret mujore të tregut, të cilat nuk pasqyrojnë profilin real të prokurimit për humbjet (të përqendruara në orët e ngarkesës maksimale me çmime më të larta), dhe as nuk adresojnë në mënyrë adekuate kufizimet ndërkufitare që reduktojnë konkurrencën dhe rrisin çmimet në ALPEX. Për më tepër, KOSTT thekson se zhvillimet e fundit gjeopolitike — përfshirë luftërat dhe krizat energjetike në rajon dhe më gjerë — kanë rritur ndjeshëm paqëndrueshmërinë dhe pasigurinë në tregjet e energjisë, duke ushtruar presion shtesë në rritjen e çmimeve. Çdo devijim nga disponueshmëria e energjisë me çmim të rregulluar (KEK) rrit më tej ekspozimin ndaj tregut. Si rezultat, ekziston një rrezik i konsiderueshëm që kostot reale të tejkalojnë nivelet e lejuara. KOSTT kërkon një rishikim të çmimit të blerjes së humbjeve në përputhje me kushtet reale të tregut.

##### **Përgjigja e ZRRE-së**

ZRRE vëren se, ndonëse në raportin e konsultimit parashikimi paraqitet si çmime mesatare mujore, këto në fakt përfaqësojnë çmimet mesatare të ponderuara sipas vëllimit në nivel orar dhe, për rrjedhojë, reflektojnë profilin e blerjeve. Çmimet e ALPEX tashmë përfshijnë ndikimin e kufizimeve në çmimet e tregut.

ZRRE konsideron se është ende shumë herët për të qenë të sigurt në vlerësimin e ndikimeve të luftës aktuale në Lindjen e Mesme mbi çmimet e energjisë<sup>1</sup>. Çmimet aktuale në tregjet e kontratave të ardhshme për naftë dhe gaz natyror kanë ndryshuar pak për pjesën e mbetur të vitit 2026, duke nënkuptuar se çmimet në bursat e energjisë mund të mos pësojnë rritje të mëdha të mëtejshme.

Për më tepër, ZRRE vëren se ALPEX është relativisht unike, pasi është një bursë relativisht e izoluar dhe për këtë arsye çmimet mund të jenë më pak të ndjeshme krahasuar me bursat e tjera. Duke marrë parasysh këtë, ZRRE nuk propozon të bëjë rregullime në parashikimet e çmimeve.

Megjithatë, ZRRE ka rregulluar parashikimet e blerjeve nga KEK dhe ALPEX në mënyrë që totalët vjetore të mbeten në përputhje me bilancin energjetik. Kjo rezulton në një rritje të lehtë të blerjeve

---

<sup>1</sup> Për shembull, kontratat futures në ICE për naftën Brent janë të [vlerësuar](#) me 107.9 \$/fuçi për dorëzim në qershor 2026 dhe 86.6 \$/fuçi për dorëzim në dhjetor 2026. Kontratat për gazin natyror TTF janë të [vlerësuar](#) me 44.9 €/MWh për dorëzim në qershor 2026 dhe në të njëjtin nivel edhe për dhjetor 2026.



të parashikuara nga KEK për pjesën e mbetur të vitit, pasi blerjet aktuale deri më tani nga KEK kanë qenë më të ulëta se sa parashikimet në Raportin Konsultativ.

Si pasojë, ka një ulje të vogël në kostot e parashikuara të blerjes së energjisë për pjesën e mbetur të vitit 2026, prej 0.198 milionë €, për shkak të vëllimeve më të mëdha që supozohet të blihen nga KEK gjatë kësaj periudhe. Ndryshimi neto në kostot e parashikuara të blerjes së energjisë për humbjet, duke përfshirë koston më të lartë aktuale në muajin mars dhe pështatjet e kombinuara të prokurimit për pjesën e mbetur të vitit, është një ulje prej 0.04 milionë €.

**ZRRE propozon të zvogëlojë koston e lejuar të blerjes së energjisë për 0.04 milionë €, për shkak të përfshirjes së kostove reale për muajin mars dhe përditësimin të përbërjes së prokurimit për pjesën e mbetur të vitit.**

#### **A2.1.2 Kostot e shërbimeve ndihmëse**

##### **Koment**

KOSTT ka paraqitur kostot e tij aktuale të prokurimit të shërbimeve ndihmëse për shkurt dhe mars 2026, ndërsa ato për janar 2026 janë dorëzuar më herët. Gjatë tre muajve të parë të vitit 2026, në total, kostot reale të prokurimit kanë qenë 0.72 milion € (6.35%) më të larta se sa ishte planifikuar fillimisht. Për këtë arsye, KOSTT kërkon që ZRRE të rrisë në përputhje me rrethanat kostot e lejuara për prokurimin e shërbimeve ndihmëse.

##### **Përgjigja e ZRRE-së**

Në përcaktimin e kostove të lejuara për blerjet e energjisë së importuar, ZRRE ka adoptuar parimin që të përdoren të dhënat më të fundit mujore reale, aty ku këto janë të disponueshme. Për muajt e tjerë përdoren parashikimet.

Duke zbatuar të njëjtin parim, ZRRE ka rishikuar koston e lejuar për prokurimin e shërbimeve ndihmëse për të përfshirë kostot reale për periudhën janar–mars 2026 dhe kostot e parashikuara për periudhën pasuese. Kostot e parashikuara mbeten të pandryshuara për muajt në vijim (dmth., janë të barabarta me vlerat reale të vitit 2025). Diferenca ndërmjet kostove reale të prokurimit në periudhën janar–mars 2026 krahasuar me janar–mars 2025 është 0.67 milion €, siç paraqitet më poshtë (Tabela 1).

Kjo është paksa e ndryshme nga vlera e raportuar nga KOSTT, e cila krahason vlerat reale për vitin 2026 me vlerat e planifikuara nga KOSTT, dhe jo me vlerat reale të vitit 2025.

**Tabla 1.** Kostot e prokurimit të shërbimeve ndihmëse në periudhën janar–mars 2025 dhe janar–mars 2026

Muaji	Njësia	Aktuale	Aktuale	Diferenca
		Jan-Mar 2025	Jan-Mar 2026	
Janar	€ mil	3.783	3.900	0.117
Shkurt	€ mil	3.825	3.853	0.028
Mars	€ mil	3.816	4.339	0.524
<b>Total (Janar – Mars)</b>	<b>€ mil</b>	<b>11.423</b>	<b>12.092</b>	<b>0.669</b>



ZRRE propozon të rrisë koston e lejuar për prokurimin e shërbimeve ndihmëse me 0.67 milion €, duke reflektuar kostot më të larta reale në periudhën janar–mars 2026 krahasuar me kostot reale në periudhën janar–mars 2025.

### **A2.1.3 Shpenzime të tjera operative**

#### **Koment**

KOSTT vëren se OPEX-i i tij real në vitin 2025 ishte 9.16 milion €, krahasuar me nivelin e propozuar për vitin 2026 prej 8.11 milion €. KOSTT ia atribuon këtë diferencë presioneve inflacioniste, përfshirë nevojën për të mbetur konkurrues në tregun e punës. Duke pasur parasysh këtë, KOSTT kërkon që ZRRE të përcaktojë OPEX-in e lejuar në përputhje me vlerat reale të vitit 2025, të cilat, sipas tij, përbëjnë një pikë referimi të auditueshme të kostove të tij “reale”.

#### **Përgjigjja e ZRRE-së**

Sipas metodologjisë së saj tarifore, ZRRE përcakton një nivel të lejuar shumëvjeçar për shpenzimet operative (OPEX). Ky bazohet në një nivel fillestar të lidhur me kostot reale, një faktor efikasiteti dhe një rregullim për inflacionin, i cili përditësohet çdo vit. Prandaj, llogaritja vjetore tashmë merr parasysh ndikimet e inflacionit në kosto.

Qëllimi i kësaj qasje është të krijojë stimuj për të licencuarit e rregulluar që të përmirësojnë efikasitetin përtej pritjeve të ZRRE-s. Duke vepruar kështu, ata mund të gjejnë kursime në shpenzimet operative, të cilat i mbajnë deri në rishikimin e ardhshëm shumëvjeçar të tarifave. Në të kundërtën, nëse nuk arrijnë të përmbushin pritjet e ZRRE-së për përmirësim të efikasitetit, kostot reale të tyre do të tejkalojnë nivelet e lejuara. Rregullimi i kostove të lejuara çdo vit për t'i barazuar me kostot reale do ta zbehte qëllimin e këtij mekanizmi stimulues, pasi do të nënkuptonte që të licencuarit nuk do të përfitonin nga tejkalimi i efikasitetit ndaj pritjeve, apo nuk do të bartnin kostot e performancës më të dobët se pritjet.

Sa i përket çështjes specifike të kostove të stafit, ZRRE vëren se provat e paraqitura më herët nga të licencuarit të tjerë tregojnë se pagat mesatare të KOSTT janë dukshëm mbi mesataren e industrisë dhe, për këtë arsye, ZRRE nuk konsideron se duhet të lejohet ndonjë rregullim i veçantë.

**ZRRE propozon të ruajë nivelin aktual të lejimit të shpenzimeve operative.**

### **A2.1.4 Shpenzime kapitale**

#### **Koment**

KOSTT identifikon një sërë projektsh investuese që nuk janë përfshirë në listën e projekteve të miratuara në Dokumentin e Konsultimit, por që i konsideron si urgjentisht të nevojshme për të mbrojtur sigurinë e sistemit dhe cilësinë e furnizimit. Këto janë:

- Rehabilitimi i NS Vallaq 100/35 kV.
- Ndërtimi i ri i NS Shtime 110/35/10(20) kV.
- Rindërtimi i linjës 6.3 kV NS Kosova B – TC Kosova B.



- Prokurimi i dy nënstacioneve mobile.
- Implementimi i Sistemit për Menaxhimin e Tregut të Energjisë Elektrike (EMMS).

### Përgjigjja e ZRRE-së

Procesi për shqyrtimin dhe miratimin e projekteve të investimeve në transmetim dhe për përfshirjen e tyre në HLM dhe tarifa është si vijon:

- KOSTT përgatit, në baza vjetore, një Plan Zhvillimor 10-vjeçar të transmetimit (PZHDHVT), i cili liston projektet e planifikuara së bashku me arsyetimet përkatëse.
- PZHT shqyrtohet dhe miratohet, pas çdo ndryshimi të nevojshëm, me vendim të Bordit të ZRRE-s, gjithashtu në baza vjetore.
- Projektet e miratuara përfshihen në planet investuese 5-vjeçare, të përgatitura para çdo periudhe tarifore shumëvjeçare, të cilat përcaktojnë koston e parashikuar.
- Shqyrtimet Periodike Tarifore (ShPT) e njohur si “Multi Year Tariff” (MYT), përfshin një lejim për zhvlerësim dhe kthim mbi koston e investimit të projekteve të miratuara të përfshira në planin 5-vjeçar të investimeve. Këto lejime fillojnë nga viti i pritshëm i vënies në shërbim të projektit dhe shtohen në Bazën Rregullatore të Aseteve (RAB).
- Në fund të çdo Shqyrtimi Periodike Tarifor, ZRRE kryen një proces “true-up”, në të cilin përcaktohen dallimet midis kostove reale dhe të parashikuara, si dhe nëse KOSTT lejohet të rikoperojë koston e çdo tejkalimi. Ky është gjithashtu momenti për të shtuar në RAB projektet që nuk janë përfshirë në planin investues, nëse KOSTT dëshmon se ato plotësojnë një nevojë të identifikuar, janë opsioni më ekonomik për përmbushjen e saj dhe janë realizuar në mënyrë efikase.

ZRRE ka vlerësuar projektet shtesë të kërkuara në raport me këtë proces dhe konkludon si vijon:

- NS Vallaq 100/35 kV – rehabilitim. Ky projekt është përfshirë në PZHT-në më të fundit të miratuar, që mbulon periudhën 2026–2035. Ai gjithashtu është përfshirë në planin aktual investues 2023–2027. Data e planifikuar e vënies në funksion është 2027, që do të thotë se do të përfshihet në RAB dhe në lejimet për zhvlerësim dhe kthim vetëm nga ai vit, duke përdorur koston e parashikuar në planin investues. Nuk duhet të shtohen kosto për vitin 2026.
- NS Shtime 110/35/10(20) kV – ndërtim i ri. Ky projekt është përfshirë në PZHT më të fundit të miratuar me datë vënie në funksion 2028. Në PZHT paraprake, që mbulonte periudhën 2025–34, data e vënies në funksion ishte 2034. Meqenëse data e vënies në funksion është pas përfundimit të periudhës aktuale MYT dhe planit investues, ky projekt do të përfshihet në RAB gjatë periudhës së ardhshme MYT.
- Rindërtimi i linjës 6.3 kV NS Kosova B – TC Kosova B | Prokurimi i dy nënstacioneve mobile | Implementimi i Sistemit për Menaxhimin e Tregut të Energjisë Elektrike (EMMS). Këto tre projekte nuk janë të përfshira në PZHT më të fundit të miratuar. Për këtë arsye, opsionet në dispozicion të KOSTT janë: (a) t’i financojë tani dhe të kërkojë përfshirjen e tyre retrospektive



në RAB si pjesë e shqyrtimit në fund të periudhës aktuale MYT; ose (b) t'i propozojë në PZH-të ardhshme dhe, pas miratimit, t'i përfshijë në planin investues 5-vjeçar për periudhën e ardhshme MYT.

**Projekti i dy nënstacioneve mobile, edhe pse aktualisht nuk është i përfshirë në planet zhvillimore apo investive të miratuara, në parim konsiderohet si investim i nevojshëm dhe pritet të përfshihet në planet përkatëse nga viti 2027 dhe RAB ku të hyjnë në operim. Megjithatë, ZRRE nuk propozon të përfshijë lejim për këto dy projekte në këtë fazë, pasi datat e planifikuara të vënies në funksion janë pas vitit 2026 dhe projektet nuk janë ende pjesë e një plani të miratuar.**



## **A2.2 KEDS (OSSH)**

### **A2.2.1 Kostot e lidhura me hapjen e tregut**

#### **Koment**

KEDS argumenton se hapja e tregut të shitjes me pakicë ka imponuar një sërë obligimesh shtesë për të, përfshirë rritjen e aktiviteteve në terren për identifikimin dhe verifikimin e konsumatorëve që kalojnë në tregun e hapur, menaxhimin e rasteve të konsumatorëve pa furnizues, realizimin e proceseve të ndërrimit të furnizuesit, rritjen e komunikimit dhe koordinimit me furnizuesit e rinjë, si dhe rritjen e ndjeshme të kërkesave për përpunimin, validimin dhe shkëmbimin e të dhënave brenda afateve shumë më të shkurtra kohore.

Për më tepër, funksionimi i një tregu të liberalizuar ka kërkuar angazhim shtesë administrativ, teknik dhe IT, përfshirë zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve mbështetëse si dhe menaxhimin e proceseve të reja të tregut. KEDS gjithashtu thekson se funksionimi i tregut të liberalizuar ka kërkuar angazhim shtesë në aspektin teknologjik dhe operativ, përfshirë zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve mbështetëse, përshtatjen e proceseve ekzistuese dhe angazhimin e burimeve shtesë njerëzore për menaxhimin e proceseve të reja të tregut.

#### **Përgjigja e ZRRE-së**

Siç është diskutuar më sipër (A2.1.3), në kuadër të metodologjisë së saj tarifore, ZRRE përcakton një lejim shumëvjeçar për shpenzimet operative (OPEX). Rregullimi i kostove të lejuara çdo vit për t'i barazuar me kostot reale do të cenonte qëllimin e mekanizmit stimulues të integruar për përmirësimin e efikasitetit.

Metodologjia Shqyrtimit Periodik (MYT) megjithatë lejon ndryshime në shpenzimet operative si rezultat i ndryshimeve në obligimet e të licencuarve. Këto ndryshime bëhen gjatë rishikimeve periodike, kur përcaktohen lejitimet për shpenzimet operative për secilën periudhë periodike tarifore. KEDS, për rrjedhojë, do të mund të kërkojë një rregullim për këtë qëllim në rishikimin e ardhshëm përkatës. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet me një shpjegim se si janë identifikuar kostot shtesë dhe me provat përkatëse të ofruara, në mënyrë që ZRRE të mund t'i auditojë këto kosto. ZRRE vëren se në aplikimin fillestar të KEDS-it apo në komentet e saj nuk është paraqitur një informacion i tillë, as vlerësime dhe as prova mbështetëse për kostot specifike shtesë të shkaktuara.

**ZRRE propozon të ruajë nivelin aktual të lejimit për shpenzimet operative.**

### **A2.2.2 Kostot operative dhe të mirëmbajtjes**

#### **Koment**

KEDS deklaron se, përveç kostove shtesë të lidhura me hapjen e tregut, shpenzimet reale operative kanë tejkalar gjithashtu nivelet e lejuara për shkak të faktorëve të tjerë jashtë kontrollit të saj. Këto përfshijnë rritjen e çmimeve të shërbimeve, materialeve dhe produkteve operative, të cilat tejkalojnë normën e inflacionit të çmimeve të konsumit të përdorur për përditësimin e lejimit në rishikimet vjetore. Faktorë të tjerë të koston përfshijnë rritjen e çmimeve të produkteve të naftës pas fillimit të konfliktit në Lindjen e Mesme. Duke pasur parasysh këtë, KEDS argumenton se shpenzimet operative



reale për vitin 2025 përbëjnë një bazë më të përshtatshme për përcaktimin e lejimeve për vitin 2026 sesa lejimi i përcaktuar sipas MYT.

### **Përgjigjja e ZRRE-së**

ZRRE vëren se tashmë ka propozuar një rregullim të konsiderueshëm në rritje të MAR-it të KEDS për të lejuar inflacionin e pagave që tejkalon inflacionin e çmimeve të konsumit. ZRRE konsideron se nuk nevojiten rregullime të mëtejshme në këtë fazë.

**ZRRE propozon të ruajë nivelin aktual të lejimit për shpenzimet operative.**

### **A2.2.3 Shpenzimet operative në komunat veriore**

#### **Koment**

KEDS deklaron se në Dokumentin e Konsultimit, ZRRE ka përfshirë një diskutim të veçantë për shpenzimet operative të lidhura me katër komunat veriore, ndryshe nga vitet e mëparshme. KEDS gjithashtu thekson se, tani që operacionet e saj në rajonin verior kanë hyrë në vitin e tretë, ajo ka një pasqyrë shumë më të qartë dhe më të detajuar të strukturës reale të kostove, kompleksitetit operacional dhe aktiviteteve që zhvillohen në këtë zonë. Sipas KEDS, këto të dhëna tregojnë se lejimet e shpenzimeve duhet të rriten.

KEDS gjithashtu propozon që komunat veriore në të ardhmen të trajtohen si një njësi operative e veçantë në nivel distrikti, me lejime të kostove që përcaktohen veçmas, duke marrë parasysh karakteristikat unike të këtij rajoni.

### **Përgjigjja e ZRRE-së**

Edhe pse kostot e shërbimit për komunat veriore nuk paraqiten në mënyrë të veçantë në Raportin Konsultativ për vitin 2026, ato njihen në përputhje me qasjen e aplikuar në vitin 2025.

Shpenzimet operative për shërbimin e katër komunave veriore janë të përfshira në lejimin e përgjithshëm për OSSH-në, i cili mbulon të gjithë Kosovën. Në vitin 2025, ZRRE ka aplikuar një rritje të këtij lejimi prej 0.573 milionë € për kostot shtesë operative të OSSH-së specifike për këto komuna (ndërsa 0.362 milionë € të tjera janë siguruar për shërbime të ofruara me kontratë). Për vitin 2026, ZRRE ka ruajtur të njëjtën qasje duke përfshirë kostot e shërbimit për komunat veriore brenda lejimit të përgjithshëm të shpenzimeve operative. Ky lejim i përgjithshëm përfshinë edhe rritjen e aplikuar në vitin 2025.

ZRRE vëren se KEDS nuk ka paraqitur një ndarje të argumentuar të kostove shtesë të shërbimit në këtë rajon dhe se si ato krahasohen me lejimin tashmë të rritur. Pa këtë informacion, është e vështirë të vlerësohet nëse rritje të mëtejshme të lejimeve janë të justifikuara. Ndryshime më thelbësore në kornizën rregullatore, siç është propozimi për trajtimin e këtij rajoni si një bazë e veçantë e kostove për qëllime të përcaktimit të të ardhurave të lejuara, trajtohen gjatë rishikimeve periodike kur MYT rifreskohet dhe nuk janë pjesë e procesit të rishikimit vjetor.

**ZRRE propozon të ruajë nivelin aktual të lejimit për shpenzimet operative.**



#### **A2.2.4 Kostot investive**

##### **Koment**

KEDS vëren se, ndonëse ZRRE ka përfshirë investime shtesë të lidhura me katër komunat veriore, ka përjashtuar kërkesën për 18.33 milion € investime shtesë të lidhura me zëvendësimin e matësve dhe infrastrukturën. Kjo ndodh pavarësisht se shumë matës kanë probleme teknike ose kanë tejkaluar jetëgjatësinë e tyre.

KEDS konsideron se këto investime duhet të pasqyrohen në mënyrë adekuate në vlerësimin përfundimtar të MAR-it për vitin 2026. Organet kompetente të metrologjisë në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) kanë intensifikuar aktivitetet e inspektimit dhe kanë filluar të aplikojnë sanksione administrative në rastet kur identifikohen matës me data të skaduar të verifikimit/vulosjes. Kjo krijon ekspozim shtesë financiar për KEDS, i cili nuk buron nga joefikasiteti operativ, por nga mungesa e fondeve për zëvendësimin e matësve të skaduar.

##### **Përgjigjja e ZRRE-së**

ZRRE merr në konsideratë shqetësimet e ngritura nga KEDS. ZRRE ka deklaruar më herët pajtueshmërinë që KEDS të realizojë investime në zëvendësimin e matësve, me kusht që këto investime të përfshihen në Bazën Rregullatore të Aseteve (RAB) dhe të reflektohen në MAR-in e KEDS-it gjatë rishikimit të ardhshëm të periudhës shumëvjeçare tarifore (MYT), në kuadër të procesit të “true-up”.

**ZRRE propozon të ruajë nivelin aktual të lejimeve për investime.**

#### **A2.2.5 Vëllimet e humbjeve**

##### **Koment**

KEDS deklaron se ulja e propozuar e lejimit të humbjeve për katër komunat veriore nga 21.5% në 18.5% është e tepruar. Sipas KEDS, niveli real i humbjeve është 24.5%, dukshëm më i lartë se lejimi për vitin 2025 prej 21.5%, dhe një ulje në 18.5% brenda një viti nuk është e realizueshme.

KEDS ka paraqitur llogaritjen e vet për vëllimin e humbjeve të lejuara në rajonin verior, duke përdorur formulën: norma e lejuar e humbjeve \* energjia hyrëse në shpërndarje + 50% \* [(norma reale e humbjeve – norma e lejuar e humbjeve) \* energjia hyrëse në shpërndarje]. KEDS konsideron se kjo është në përputhje me mekanizmin e dakorduar të ndarjes 50:50 për humbjet “shtesë”, duke përfshirë gjithashtu 50% të diferencës midis nivelit real dhe atij të lejuar të humbjeve. KEDS gjithashtu propozon që llogaritja e humbjeve të bëhet duke përdorur normën e pandryshuar të lejuar prej 21.5% dhe normën reale të humbjeve për vitin 2025 prej 24.5%.

E aplikuar në energjinë hyrëse në rajonin verior, të vlerësuar nga KEDS në 259 GWh, kjo duhet të japë një lejim të humbjeve prej 59.6 GWh për këtë rajon. Megjithatë, vlera reale e futur nga KEDS në modelin shoqëruar MAR është 71.4 GWh (e barabartë me një normë humbjeje prej 27.6%). Ky ndryshim nuk është shpjeguar në komentet e KEDS.



## Përgjigja e ZRRE-së

ZRRE konsideron se KEDS e ka keqkuptuar faktorin e ndarjes 50:50 për humbjet e tepërta. Ky aplikohet si pjesë e llogaritjes së rregullimit vjetor për diferencat ndërmjet humbjeve reale dhe atyre të lejuara (i cili është një input në rregullimin KREV), dhe jo në llogaritjen e humbjeve të lejuara në vitin aktual. Për vitin 2026, kjo vlerë e ndarë është llogaritur në 0.42 milionë €, e cila është përfshirë në përshtatjen e të hyrave (KREvt) dhe, rrjedhimisht, në HLM-në e KEDS-it.

ZRRE vazhdon të llogarisë humbjet e lejuara si: norma e lejuar e humbjeve \* *energjia hyrëse në shpërndarje*.

ZRRE gjithashtu konsideron se është e përshtatshme të ulet objektivi i humbjeve të lejuara nga viti në vit. Në kuadër të HLM-së, ZRRE ka lejuar shpenzime operative shtesë për përmirësimin e performancës së shpërndarjes në rajonin verior dhe ka alokuar gjithashtu fonde për investime që reduktojnë humbjet. Pritshmëria është që kjo të reflektohet në një nivel në rënie të humbjeve. ZRRE pranon se KEDS nuk i ka realizuar investimet e planifikuara në vitin 2025, por nuk konsideron se kjo duhet të shpërblehet në mënyrë të tërthortë duke mos e rregulluar nivelin e humbjeve.

**ZRRE propozon të ruajë nivelet aktuale të humbjeve të lejuara.**

### **A2.2.6 Çmimi i blerjes së energjisë**

#### **Koment**


Në aplikimin e saj fillestar, KEDS ka parashikuar një çmim mesatar të blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve prej 151.31 €/MWh. Ky parashikim është bazuar në të dhënat e tregut të së ardhmes deri më 1 tetor 2025.

Duke marrë parasysh pasigurinë aktuale në tregjet e energjisë, KEDS ka përditësuar parashikimet e saj duke përdorur çmimet reale për periudhën janar–mars 2026 dhe projeksione të reja. Këto projeksione bazohen në të dhënat e tregut deri më 17 prill 2026 për dy tregje relevante rajonale, Greqinë dhe Hungarinë. Këto përditësime rezultojnë në një çmim mesatar të rishikuar të blerjes së energjisë së importuar për vitin 2026 prej 138.40 €/MWh, të cilin KEDS propozon të përdoret në llogaritjen e kostos së blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve në shpërndarje. Kjo krahasohet me parashikimin e ZRRE-s në Raportin Konsultativ për çmimin mesatar për vitin 2026 prej 129.76 €/MWh.

Parashikimet mujore të çmimeve mesatare të importit krahasohen më poshtë (Figura 2).



**Figura 1. Parashikimet e çmimeve të importit për blerjet e humbjeve të OSSH-së – krahasim**



### Përgjigja e ZRRE-së

Siç është diskutuar më sipër (A2.1.1), ZRRE konsideron se është ende herët për të vlerësuar me saktësi ndikimet e luftës aktuale në Lindjen e Mesme mbi çmimet e energjisë dhe vëren se çmimet në tregjet e të ardhmes për naftën dhe gazin natyror janë ose në rënie ose kanë ndryshuar pak për pjesën e mbetur të vitit 2026. Në këtë drejtim, ZRRE vëren diferencat relativisht të vogla ndërmjet parashikimit të saj mujor të çmimeve dhe parashikimit të përditësuar nga KEDS. Megjithatë, ZRRE konsideron se është e përshtatshme të bëhet një rregullim i vogël në rritje i çmimeve të parashikuara të importit, duke marrë pjesërisht parasysh këtë diferencë. Rregullimi është vendosur për 2.65 €/MWh, ose 30% të diferencës ndërmjet parashikimeve të përditësuar të çmimeve nga KEDS dhe parashikimit të mëparshëm të ZRRE-s.

ZRRE gjithashtu ka përditësuar kostot e lejuara duke përdorur vëllimet dhe kostot reale për periudhën janar–mars 2026 (ndërsa në Raportin Konsultativ janë përdorur kostot reale vetëm për janar dhe shkurt). Më pas, ZRRE ka përditësuar vëllimet e parashikuara për pjesën e mbetur të vitit 2026 në mënyrë që ndarja totale e blerjeve midis KEK dhe importit të mbetet e pandryshuar.

Ndikimi neto i këtyre ndryshimeve është rritja e kostove të parashikuara të blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve me 0.85 milionë €.

Kostot reale të blerjeve në mars 2025 janë 2.04 milion € më të larta se parashikimi i përdorur më parë në Raportin Konsultativ, për shkak të niveleve më të larta të importit. Megjithatë, kjo kompensohet nga supozimi se, gjatë pjesës së mbetur të vitit, do të ketë blerje pak më të larta nga KEK sesa ishte parashikuar më parë, pasi blerjet reale deri më tani kanë qenë më të ulëta se sa ishte pritur fillimisht (Tabela 5). Si pasojë, ka një rënie në kostot e parashikuara të blerjes së energjisë për pjesën e mbetur të vitit 2026 prej 2.18 milion €, për shkak të vëllimeve më të mëdha të supozuara të blerjeve nga KEK gjatë kësaj periudhe. Përshtatja e vogël neto në rritje i çmimeve të parashikuara të blerjes së energjisë për periudhën prill–dhjetor 2026 shton për 0.99 milionë € në kostot e lejuara.



**ZRRE propozon të rrisë koston e lejuar të blerjes së energjisë me 0.85 milion €.**

#### ***A2.2.7 Të ardhurat e parregulluara***

##### **Koment**

KEDS propozon të aplikohet një faktor ndarjeje prej 50% për të gjitha të ardhurat e parregulluara. Kjo krahasohet me qasjen aktuale të ZRRE-s, e cila aplikon një faktor ndarjeje prej 0% për të ardhurat e parregulluara deri në nivelin e parashikuar nga ZRRE (dmth., këto të ardhura i alokohen plotësisht uljes së kostove që duhet të mbulohen nga tarifat e energjisë elektrike) dhe një faktor ndarjeje prej 25% përtej këtij niveli. KEDS konsideron se lejimi i një niveli më të lartë ndarjeje do të forconte stimujt për të kërkuar mënyra për rritjen e të ardhurave të parregulluara, në përfitim përfundimtar të konsumatorëve të energjisë elektrike.

##### **Përgjigjja e ZRRE-së**

Qëndrimi i ZRRE-s është se rregullimet aktuale ofrojnë stimuj të mjaftueshëm për KEDS që të rrisë të ardhurat e parregulluara mbi nivelet e pritshme, pasi KEDS mban 25% të çdo të ardhure shtesë. Prandaj, ZRRE konsideron se nuk nevojitet asnjë ndryshim.

**ZRRE propozon të ruajë mekanizmin aktual të ndarjes për të ardhurat e parregulluara.**



## A2.3 KESCO (FSHU)

### A2.3.1 Çmimet e parashikuara të shitjes me shumicë

KESCO argumenton se çmimet më të ulëta të importit në janar dhe shkurt 2026, krahasuar me parashikimet e përfshira në aplikimin e saj, janë mashtruese si tregues për çmimet e pritshme për të gjithë vitin 2026, dhe se duke u mbështetur në këto, ZRRE po nënvlerëson çmimet e pritura të importit. KESCO paraqet një sërë argumentesh në mbështetje të këtij qëndrimi:

- Pas fillimit të konflikteve në Lindjen e Mesme, ka pasur një rritje të madhe të çmimeve të energjisë në bursat evropiane të energjisë elektrike. Nuk ka prova që çmimet do të kthehen në nivelet para krizës gjatë vitit 2026. Sinjalet politike si dhe faktorët e tregut tregojnë për çmime të larta dhe të paqëndrueshme në të ardhmen. Ekspertët globalë të energjisë dhe institucionet ndërkombëtare politike theksojnë se çmimet e energjisë nuk pritet të kthehen në nivelet para luftës gjatë këtij viti, duke reflektuar presione strukturore.
- Analizat e tregut tregojnë se edhe në skenarin e një armëpushimi, tregjet e naftës mund të kërkojnë deri në një vit për t'u afruar me nivelet para krizës, për shkak të ndërprerjeve të furnizimit, kufizimeve logjistike dhe nevojës për rindërtimin e rezervave. Kjo është në përputhje me vlerësimet më të gjera gjeopolitike, veçanërisht në rajonet kryesore të furnizimit, të cilat kanë krijuar një premium të qëndrueshëm rreziku në çmime.
- Sipas analizave të institucioneve evropiane, përfshirë dokumente të Këshillit Evropian dhe Komisionit Evropian (mars 2026), tregu i energjisë në Evropë vazhdon të jetë i ndjeshëm ndaj krizave gjeopolitike dhe luhatjeve të furnizimit për shkak të varësisë nga importi. Një nga përfundimet kryesore është se gjatë periudhave të tensioneve apo konflikteve ndërkombëtare, kostot e importit rriten ndjeshëm. Raporti thekson se çmimet e energjisë elektrike në tregjet me shumicë mbeten dukshëm më të larta se nivelet para krizës së vitit 2021, me rritje rreth 40%, ndërsa çmimet e gazit janë rritur edhe më shumë.

KESCO gjithashtu argumenton se nuk është e përshtatshme përdorimi i çmimeve të ALPEX si pikë referimi. Sipas saj:

- Tregu ALPEX është ende në fazë zhvillimi dhe karakterizohet nga likuiditet i kufizuar dhe pjesëmarrje e reduktuar. Sipas analizës së Entit Rregullator të Energjisë (ERE), tregu ditë në ALPEX ende nuk ka arritur nivelin e nevojshëm të likuiditetit për të shërbyer si bazë e qëndrueshme për kontrata afatgjata të energjisë, veçanërisht ato të lidhura me burime të rinovueshme dhe mekanizma të çmimeve të garantuara.
- Një nga arsyet kryesore pse ALPEX ende nuk konsidërohet treg referencë është niveli i ulët i likuiditetit dhe kapaciteti i kufizuar për të absorbuar kapacitete të reja pa ndikim në çmime. Për KESCO-n, kjo nënkupton ekspozim më të madh ndaj paqëndrueshmërisë së çmimeve dhe vështirësi në ndërtimin e kontratave afatgjata të qëndrueshme me prodhuesit e energjisë. Prandaj, përdorimi i tij si pikë kyçe referimi për vlerësimin e çmimeve nuk ofron një pasqyrë të plotë dhe të besueshme të kushteve të tregut rajonal.



Në fund, KESCO argumenton se ekziston nevoja për një proces më dinamik të parashikimit të kostove të energjisë me shumicë dhe për rregullim më fleksibil të tarifave, duke marrë parasysh pasiguritë dhe luhatjet e mëdha të çmimeve. Në këtë drejtim, KESCO tërheq vëmendjen ndaj mospërputhjeve ndërmjet parashikimeve të ZRRE-s dhe çmimeve reale të importit në vitin 2025, të cilat mund të çojnë në ndërhyrje emergjente dhe rishikime të shpeshta tarifore, duke ulur parashikueshmërinë dhe stabilitetin.

Duke marrë parasysh sa më sipër, KESCO propozon një kosto të lejuar për blerjen e energjisë me shumicë prej 205.63 milion €. Kjo është më e ulët se propozimi i saj fillestar prej 229.04 milion €, por më e lartë se propozimi i ZRRE-s në Dokumentin e Konsultimit prej 177.81 milion €. KESCO nuk ka paraqitur detajet se si është llogaritur ky nivel i rishikuar i propozuar.

### **Përgjigja e ZRRE-së**

Siç është diskutuar më sipër (A2.1.1), ZRRE konsideron se është ende herët për të vlerësuar me saktësi të plotë ndikimet e luftës aktuale në Lindjen e Mesme mbi çmimet e energjisë dhe vëren se çmimet në tregjet e të ardhmes për naftën dhe gazin natyror janë ose në rënie ose kanë ndryshuar pak për pjesën e mbetur të vitit 2026.

Për këtë arsye, ZRRE ka aplikuar të njëjtën qasje si për KEDS në përditësimin e kostove të parashikuara të blerjeve me shumicë të energjisë për obligimet FSHU të KESCO-s. ZRRE ka përdorur vëllimet dhe kostot reale për periudhën janar–mars 2026 (ndërsa më herët janë përdorur kostot reale vetëm për janar dhe shkurt). Më pas, ZRRE ka përditësuar vëllimet e parashikuara për pjesën e mbetur të vitit 2026 në mënyrë që ndarja totale e blerjeve midis KEK, burimeve të ripërtëritshme dhe importit të mbetet e pandryshuar. ZRRE ka ruajtur çmimet e mëparshme të parashikuara për blerjet nga muaji prill e tutje. ZRRE gjithashtu ka aplikuar një rregullim të vogël në rritje të çmimeve të parashikuara të importit për pjesën e mbetur të vitit prej 2.65 €/MWh, njësoj si për KEDS. Ndikimi neto i këtyre ndryshimeve është një ulje e vogël e kostove të parashikuara të blerjes së energjisë prej 1.45 milionë €, (para se të merren parasysh rregullimet pasuese të marzhës së shitjes me pakicë dhe lejimit të kapitalit qarkullues).

**ZRRE propozon të rrisë koston e lejuar të blerjes së energjisë me 1.45 milion €.**

### **A2.3.2 Ndikimi i ndërprerjeve në Kosova A dhe Kosova B dhe profilizimi i kostove**

#### **Koment**

Gjatë vitit 2026, për shkak të mirëmbajtjes kapitale në Termocentralet Kosova A dhe Kosova B, pritet të ketë ndërprerje me kohëzgjatje të konsiderueshme në prodhimin vendas të energjisë elektrike, duke kërkuar nivele më të larta të importit dhe, rrjedhimisht, kosto më të larta të blerjes së energjisë me shumicë. Në vitin 2027, pritet e kundërta, me rritjen e besueshmërisë së Termocentraleve Kosova A dhe Kosova B, që do të çojë në ulje të importeve dhe të kostove të blerjes së energjisë me shumicë. Në mungesë të ndonjë ndërhyrje rregullatore, kjo nënkupton tarifa më të larta në vitin 2026 dhe tarifa më të ulëta në vitin 2027.



Në një letër të datës 10 mars 2026, ZRRE ka kërkuar që KEK dhe KESCO të pajtohen për menaxhimin e ndikimeve të mundshme te konsumatorët duke rënë dakord për shtyrjen e një pjese të kostove të blerjes së energjisë nga KEK nga viti 2026 në vitin 2027. Kjo do të mundësonte “zbutjen” e kostove të blerjes së energjisë me shumicë gjatë këtyre dy viteve, duke shmangur nevojën për një rritje fillestare të tarifave e më pas uljen e tyre. ZRRE e ka përfshirë këtë supozim në të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM-n) e propozuar për vitin 2026.

KESCO shpreh gatishmërinë për të kontribuar në gjetjen e një zgjidhje. Megjithatë, KESCO shpreh shqetësimin se nuk ka garanci që kostot e shtyra, përfshirë kostot e interesit mbi huamarrjet për të mbuluar mungesën e përkohshme të likuiditetit, do të përfshihen në tarifën e vitit 2027, duke e ekspozuar atë ndaj rrezikut financiar. Në këtë drejtim, KESCO vëren se ekzistojnë raste të tjera ku rikuperimi i kostove shtyhet në praktikë (p.sh. vonesat në rritjen e çmimeve dhe vonesat në disbursimin e subvencioneve shtetërore), të cilat gjithashtu duhet të njihen dhe të lejohet mbulimi i kostove të interesit.

### **Përgjigja e ZRRE-së**

ZRRE e mirëpret gatishmërinë e KESCO-s për të mbështetur gjetjen e një zgjidhjeje për zbutjen e ndikimeve të punimeve të rehabilitimit në Termocentralet Kosova A dhe Kosova B në tarifën e energjisë elektrike. ZRRE ka treguar tashmë angazhimin e saj për të lejuar rikuperimin e plotë të kostove të shtyra, përfshirë edhe kostot e tjera të arsyeshme përcjellëse në vitin 2027. Duke marrë parasysh këtë angazhim, ZRRE konsideron se shqetësimet e KESCO-s lidhur me rikuperimin e kostove janë adresuar.

**ZRRE propozon të vazhdojë të supozojë shtyrjen e një pjese të kostove të blerjes së energjisë në vitin 2027, në mënyrë që të mundësohet zbutja e këtyre kostove midis viteve 2026 dhe 2027.**

### **A2.3.3 Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes**

#### **Koment**

KESCO argumenton se shpenzimet operative të lejuara nga ZRRE, prej 8.19 milion €, janë të pamjaftueshme dhe nuk pasqyrojnë plotësisht ndikimet e obligimeve rregullatore dhe inflacionit në kostot e saj. KESCO tërheq vëmendjen ndaj rritjes së shpenzimeve të shkaktuara nga nevoja për të zbatuar liberalizimin e tregut. Që nga marsi 2025, KESCO është detyruar të angazhohet në informimin e mbi 100,000 konsumatorëve komercialë për procesin e liberalizimit, gjë që ka çuar në rritje të kostove të stafit dhe komunikimit. Po ashtu, kjo ka kërkuar që KESCO të përballojë kosto të reja lidhur me verifikimin e statusit të konsumatorëve. Megjithatë, KESCO nuk paraqet detaje apo prova për rritjet specifike të kostove që do të mbështesnin këto pohime të përgjithshme.

KESCO gjithashtu argumenton se qasja e ZRRE-s për indeksimin e shpenzimeve sipas inflacionit të çmimeve të konsumit nuk pasqyron strukturën reale të kostove të saj, e cila është e orientuar kryesisht drejt pagave dhe shërbimeve të kontraktuara, ku inflacioni është më i lartë se inflacioni i çmimeve të konsumit. Po ashtu, kjo qasje nuk merr parasysh ndikimin e rritjes së numrit të konsumatorëve (rreth 4% në vit). Faktori i efikasitetit, sipas KESCO-s, e penalizon më tej atë, pasi supozon kontroll mbi faktorët e koston si rritja e pagës minimale, gjë që në praktikë KESCO nuk e ka.



Argumenti i fundit i ngritur nga KESCO është se, ndonëse ZRRE ka lejuar shpenzime shtesë për faturim në vitin 2025 (prej 449,600 €), procesi manual i faturimit ka rezultuar sfidues. KESCO ka nisur një procedurë prokurimi për shërbime faturimi, por oferta më e ulët që ka qenë teknikisht e pranueshme ishte 18 herë më e lartë se shpenzimet e lejuara nga ZRRE.

Duke marrë parasysh sa më sipër, KESCO mban qëndrimin se propozimi i saj fillestar për një lejim prej 10.29 milion € pasqyron më mirë kostot e saj reale.

### **Përgjigjja e ZRRE-së**

Siç është diskutuar më sipër (A2.1.3), në kuadër të metodologjisë së saj tarifore, ZRRE përcakton një lejim shumëvjeçar për shpenzimet operative (OPEX). Rregullimi i kostove të lejuara çdo vit për t'i barazuar me kostot reale do të cenonte qëllimin e mekanizmit të stimujve për përmirësimin e efikasitetit, i cili është i integruar në këtë qasje.

Metodologjia e shqyrtimit shumëvjeçar tarifor (MYT) megjithatë lejon ndryshime në shpenzimet operative si rezultat i ndryshimeve në obligimet e të licencuarve. Këto ndryshime bëhen gjatë rishikimeve periodike, kur përcaktohen lejimet për shpenzimet operative për secilën periudhë të shqyrtimit shumëvjeçar tarifor (MYT). KESCO, për rrjedhojë, do të ketë mundësi të kërkojë një rregullim për këtë qëllim në rishikimin e ardhshëm përkatës. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet me një shpjegim se si janë identifikuar kostot shtesë dhe me provat përkatëse, në mënyrë që ato të mund të auditohen nga ZRRE.

**ZRRE propozon të ruajë nivelin aktual të shpenzimeve operative të lejuara.**

#### **A2.3.4 Kostot e bartshme (pass-through costs)**

##### **Koment**

Në propozimin e saj, KESCO ka supozuar se tarifat e OST/OT dhe OSSH do të rriten në vitin 2026 me 20% krahasuar me nivelet e vitit 2025. Megjithatë, duke shqyrtuar Dokumentet e Konsultimit, ZRRE kupton se tarifat e OSSH dhe OS/OTnë fakt pritet të ulen lehtë, ndërsa tarifat për përdorimin e rrjetit të transmetimit (TNUOS), të cilat mbulojnë kostot e TSO-së, pritet të rriten me rreth 90% krahasuar me nivelet e vitit 2025 (nga 4.939 €/kW në një vlerë të parashikuar prej 8.603 €/kW).

KESCO e konsideron këtë rritje të pajustificuar. KESCO gjithashtu shpreh shqetësimin se kjo rritje shton rrezikun e saj lidhur me mospagesat nga konsumatorët, pasi rrit pjesën e të ardhurave të mbledhura që u transferohen entiteteve të tjera dhe, rrjedhimisht, nuk janë më të disponueshme për KESCO.

### **Përgjigjja e ZRRE-së**

Llogaritja e tarifës për shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit (TNUOS) ndjek metodologjinë e miratuar dhe reflekton kostot përkatëse. Në këtë rast, rritja e madhe nga viti 2025 në 2026 nuk është rezultat i ndryshimit të HLM të KOSTT-it, por e një rënie të konsiderueshme të rregullimeve kompensuese dhe, rrjedhimisht, i nivelit të mbetur të kostove të TSO-së pas këtyre rregullimeve që mbuloohen përmes tarifave për shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit (TNUOS).



Në vitin 2024, KOSTT ka përfituar nga një rritje e njehershme e të ardhurave të jashtme, e cila është përdorur për të ulur kostot që do të mbuloreshin nga tarifat TNUOS në vitin 2025. Një përfitim i tillë nuk ka ekzistuar në vitin 2025, gjë që bën që kostot neto pas rregullimeve, të cilat duhet të mbulohen përmes tarifave për shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit (TNUOS) në vitin 2026, të jenë më të larta dhe, për rrjedhojë, këto tarifa të jenë rritur.

**ZRRE konsideron se nuk nevojitet asnjë veprim në përgjigje të këtij komenti.**



## **A2.4 KEK**

### **A2.4.1 Ndryshimet në tarifat e OST/OT dhe OSSH të paguara nga KESCO**

#### **Koment**

KEK ka rënë dakord për një çmim të energjisë së furnizuar për KESCO (për shërbimet universale të furnizimit) prej 29.50 €/MWh, i cili do të zbatohet deri më 31 mars 2027. KEK vëren se ky çmim është llogaritur në bazë të tarifave aktuale të OST/OT dhe OSSH që duhet të paguhet nga KESCO. KEK kërkon konfirmim se, nëse këto tarifa rriten, KESCO do të lejohet të përfshijë këtë rritje në tarifat e saj të shitjes me pakicë, në mënyrë që të mund të vazhdojë t'i paguajë KEK-ut çmimin e plotë të kontraktuar.

#### **Përgjigja e ZRRE-së**

ZRRE konfirmon se çdo rritje e tarifave të OST/OT dhe/ose OSSH do të kalojë (do të reflektohet) në tarifat e shitjes me pakicë të aplikuara për konsumatorët e shërbimit universal.

**ZRRE konsideron se nuk kërkohet asnjë veprim në përgjigje të këtij komenti.**

### **A2.4.2 Kostot e humbjeve të përfshira në të ardhurat e lejuara të OST dhe OSSH**

#### **Koment**

KEK vëren se gjatë vitit 2026 njësitë e saj gjeneruese do të jenë jashtë shërbimit për periudha të zgjatura për shkak të nevojës së njohur për investime urgjente rehabilituese dhe zgjatje të jetëgjatësisë. KEK gjithashtu vëren se një pjesë e konsiderueshme e shpenzimeve operative të saj (vlerësuar në 45% të totalit) janë fikse, ndërsa të ardhurat nga shitja e energjisë për mbulimin e humbjeve të transmetimit dhe shpërndarjes janë plotësisht variable. Kjo krijon rrezik të mospërputhjes ndërmjet të ardhurave dhe kostove gjatë periudhës së këtyre ndërprerjeve, duke rrezikuar qëndrueshmërinë financiare të KEK-ut.

KEK gjithashtu argumenton se qasja aktuale e ZRRE-s për llogaritjen e çmimit të lejuar për humbjet, si mesatare e ponderuar e çmimeve në kontratat bilaterale të KEK-ut me KOSTT dhe KEDS dhe të importeve, është e papërshtatshme. Në veçanti, KEK argumenton se kjo është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe rregullative që kërkojnë që çmimet të përcaktohen në mënyrë konkurruese.

KEK propozon që zgjidhja e këtyre çështjeve të jetë që ZRRE të përcaktojë çmimin e lejuar për humbjet vetëm mbi bazën e çmimeve të importit, si përfaqësim i çmimit të tregut (dmth., kostos marginale të furnizimit). KEK do të ishte më pas i lirë të hyjë në kontrata bilaterale me KOSTT dhe KEDS për furnizimin me energji sipas kushteve dhe çmimeve që mbulojnë plotësisht kostot e tij, përfshirë nevojën për rikuperimin e kostove fikse nga një volum më i ulët i shitjeve të energjisë.

#### **Përgjigja e ZRRE-së**

Propozimi i KEK-ut duket se do t'i lejonte atij të vlerësojë çmimin e kontratave me KOSTT dhe KEDS në nivele pak më të ulëta se çmimi i importit (import price parity). Një gjë e tillë do të nënkuptonte se KEK mund të realizojë fitime të jashtëzakonshme duke krijuar një barrë shtesë për konsumatorët. Si



ilustrim, ZRRE vlerëson se, nëse KEK do t'i përcaktonte çmimet e shitjes e parashikuara për KOSTT dhe KEDS në nivel të barabartë me çmimin e importit, në vend të 36.0 €/MWh aktual, do të përfitonte rreth 60 milionë € shtesë në vitin 2026, që do të ishte ekuivalente me një rritje të faturave të konsumatorëve prej 8.6 €/MWh.

ZRRE konsideron se një rezultat i tillë është i papranueshëm, veçanërisht duke marrë parasysh se KEK është ndërmarrje në pronësi shtetërore. Në vend të kësaj, ZRRE vlerëson se është e përshtatshme të vazhdohet të supozohet se kontratat bilaterale të KEK-ut me KOSTT dhe KEDS do të vlerësohen me kosto, dhe se treguesi më i mirë i kostos reale është çmimi historik i kontratave.

Sa i përket çështjes specifike të një mospërputhjeje të mundshme ndërmjet kostove dhe të ardhurave për shkak të ndërprerjeve të zgjatura në vitin 2026 për rehabilitim, ZRRE vëren se këto investime do t'i mundësojnë KEK-ut rritjen e disponueshmërisë së kapaciteteve, dhe rrjedhimisht rritjen e energjisë së shitur dhe të të ardhurave në vitet pasuese. Kjo rritje pritet të kompensojë çdo humbje të mundshme financiare në vitin 2026.

**ZRRE propozon të mos bëhet asnjë ndryshim në supozimet mbi çmimet e paguara nga KEK-u për KOSTT dhe KEDS.**

#### **A2.4.3 Zvoglimi e tarifës së operimit të sistemit**

##### **Koment**

KEK argumenton se rritja e madhe e tarifave të shërbimeve të sistemit për gjeneratorët e lidhur në transmetim, e aplikuar nga maji i vitit 2025, është e paarsyeshme dhe jo në përputhje me ligjin dhe, për rrjedhojë, duhet të anulohet. Në mënyrë specifike, KEK pohon se tarifa e rritur nuk është kostorefleksive dhe, si e tillë, është në kundërshtim me kërkesat e nenit 37(6) të Ligjit për Energjinë Elektrike (L-05/L-85).

KEK gjithashtu kërkon që pagesat shtesë që ka bërë ndaj KOSTT-it për shkak të rritjes së tarifave të shërbimeve të sistemit nga 1 maj 2025 të rimbursohen.

##### **Përgjigjja e ZRRE-së**

ZRRE vëren se llogaritja e tarifave të operimit të sistemit dhe tarifave të tjera të lidhura me transmetimin ndjek metodologjinë e miratuar, e cila është e dizajnuar të jetë kosto reflektuese. Rritja e madhe e identifikuar nga KEK i atribuohet kostove më të larta të lidhura me operimin e sistemit, në veçanti prokurimit të shërbimeve ndihmëse.

ZRRE gjithashtu vëren se ndryshimet retroaktive në tarifa dhe pagesa, në përgjithësi, duhet të shmangen. Lejimi i ndryshimeve të tilla do të rriste ndjeshëm rrezikun rregullator, pasi do të mundësonte rihapjen efektive të vendimeve të mëparshme.

**ZRRE konsideron se nuk kërkohet asnjë veprim në përgjigje të këtij komenti.**



## **A2.5 Elektroserver**

### **A2.5.1 Tarifa për shërbimet e shpërndarjes në komunat veriore**

#### **Koment**

Elektroserver pyet pse Raporti Konsultativ për vitin 2026, ndryshe nga ai për vitin 2025, nuk përfshin informacion të detajuar mbi kostot e lejuara për shërbimet e shpërndarjes në komunat veriore dhe mbi mënyrën se si do të përcaktohet tarifa përkatëse.

#### **Përgjigjja e ZRRE-së**

Edhe pse këto kosto nuk paraqiten në mënyrë të veçantë në Raportin Konsultativ për vitin 2026, ato njihen dhe trajtohen si vazhdim i periudhës rregullatore, në përputhje me qasjen e aplikuar në vitin 2025.

Shpenzimet operative për shërbimin e katër komunave veriore janë të përfshira në lejin e përgjithshëm për OSSH-në, i cili mbulon të gjithë Kosovën. Në vitin 2025, ZRRE ka ofruar një rritje të këtij lejimi prej 0.573 milionë € për kostot shtesë operative të OSSH-së specifike për këto komuna (ndërsa 0.362 milionë € të tjera janë siguruar për shërbime të ofruara me kontratë). Për vitin 2026, ZRRE ka ruajtur të njëjtën qasje duke përfshirë kostot e shërbimit për komunat veriore brenda lejit të përgjithshëm të shpenzimeve operative. Ky lejim i përgjithshëm përfshin edhe rritjen e aplikuar në vitin 2025.

Për shmangien e çdo paqartësie, përcaktimi i çdo pagese kontraktuale ndërmjet KEDS dhe Elektroserver për kostot e shërbimeve të ofruara në komunat veriore është çështje tregtare bilaterale, e cila është jashtë kompetencave rregullatore të ZRRE-s.

**ZRRE propozon të mos bëjë asnjë ndryshim në shpenzimet operative të lejuara për OSSH.**

### **A2.5.2 Niveli i investimeve në komunat veriore**

#### **Koment**

Elektroserver konsideron se niveli i miratuar i investimeve shtesë në komunat veriore (prej 1.76 milion €) është i pamjaftueshëm duke marrë parasysh nevojat e rrjetit. Elektroserver gjithashtu vëren se investimet e planifikuara prej 2.29 milion € në vitin 2025 nuk janë realizuar, pavarësisht se KEDS ka marrë pagesa të tarifave të rrjetit nga Elektroserver shumë më të larta se kjo shumë (vetëm 5.14 milion € në vitin 2025).

#### **Përgjigjja e ZRRE-së**

ZRRE thekson se investimet e miratuara janë vlerësuar mbi bazën e nevojave prioritare dhe kostove të justifikuar, në përputhje me kornizën rregullatore në fuqi.

ZRRE vëren se, nëse KEDS nuk ka arritur të realizojë plotësisht programet e planifikuara të investimeve në vitin 2025, atëherë duket e pamundur që të jetë në gjendje të realizojë nivele më të larta investimesh në vitin 2026. ZRRE gjithashtu vëren se nuk ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet



tarifave të rrjetit dhe investimeve sipas rajoneve, pasi shpërndarja e tarifave për investime bazohet në një vlerësim të prioriteteve të përgjithshme në të gjithë Kosovën.

Megjithatë, ZRRE mbetet e gatshme të shqyrtojë propozime të mirëjustifikuara për investime shtesë, me kusht që ato të përfaqësojnë një nivel realist investimesh që KEDS mund t'i realizojë.

### **A2.5.3 *Niveli i lejuar i humbjeve***

#### **Koment**

Elektroserver pyet pse niveli i lejuar i humbjeve për komunat veriore është ulur në 18.5% për vitin 2026, duke marrë parasysh se kushtet reale nuk kanë ndryshuar ndjeshëm dhe se investimet e planifikuara për uljen e humbjeve në vitin 2025 nuk janë realizuar.

#### **Përgjigja e ZRRE-së**

ZRRE përcakton objektiva që i konsideron realistë, por sfidues, për të licencuarit në reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike dhe lejon shpenzime të mjaftueshme operative dhe kapitale për arritjen e këtyre objektivave. Nëse të licencuarit nuk arrijnë të bëjnë investimet dhe përmirësimet e nevojshme operative për uljen e humbjeve, ZRRE nuk është e obliguar të rrisë objektivat e humbjeve në përgjigje të kësaj. Një veprim i tillë do të krijonte një nxitje të gabuar për mosinvestim në reduktimin e humbjeve.

ZRRE vëren se përcaktimi i objektivave të humbjeve për komunat veriore është i ndërlikuar për shkak të mungesës së të dhënave të besueshme mbi nivelin e humbjeve dhe potencialin për reduktimin e tyre. Duke e marrë parasysh këtë, ZRRE është e gatshme të rishikojë objektivat e humbjeve për këtë rajon nëse ofrohen të dhëna të mjaftueshme dhe të mirëargumentuara. ZRRE ka përdorur përfundimet nga studime të pavarura mbi potencialin e reduktimit të humbjeve në rajone të tjera të Kosovës gjatë përcaktimit të objektivave dhe do të konsideronte edhe rezultatet e studimeve të ngjashme për komunat veriore.

**ZRRE propozon të ruajë nivelet aktuale të lejuara të humbjeve.**